

RAPORTI VJETOR 2018

INSTITUTI I STUDIMIT TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI



Përmbajtja

I. PASQYRË PËRMBLEDHËSE E AKTIVITETIT TË ISKK GJATË VITIT 2018

i. Misioni.....	1
ii. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit.....	2
iii. Konkluzionet.....	8

II. AKTIVITETET

1. PROJEKTET

1.1 Projekte edukuese: “Komunizmi në Shqipëri: fantazi apo realitet?”- seri bisedash nëpër shkolla.....	11
1.2 Projektet dëshmuese: Krijimi i arkivës audio-vizuale të dëshmimeve të ish të përndjekurve politikë.....	15
Mbledhja e memuarëve, ditareve, shënimeve autentike.....	18
1.3 Projektet dokumentuese: Krijimi i një database-i mbi viktimat e komunizmit.....	19
1.4 Projekte informuese-sensibilizuese: Muzeu virtual i komunizmit në Shqipëri.....	23
“PARA dhe PAS”- Ekspozitë fotografike online.....	32
“Komunizmi në Shqipëri”- Seri video-montazhesh me rrëfimet e të mbijetuarve.....	34

2. BOTIMET

2.1 Botimet studimore/dokumentuese.....	36
2.2 Botime memuaristike.....	42
2.3 Literaturë nga burgjet/kampet.....	48

3. KONFERENCA/KUALIFIKIME

3.1 Konferenca të organizuara nga ISKK.....	49
3.2 Bashkëpunime/ pjesëmarrje në konferenca.....	52
3.3 Takime.....	56
3.4 Akte zyrtare.....	57
3.5 Trajnime.....	58
3.6 Publikime në media.....	59

4. BASHKËPUNIME SHKENCORE/ INTERSHIP

4.1 Bashkëpunime studimore.....	61
4.2 Udhëheqje diplomash masteri dhe bachelor.....	61
4.3 Intership.....	62

5. AKTE INFORMIMI

5.1 Asistencë informacioni për organet ndërkombëtare të drejtësisë.....	62
5.2 Informimi i publikut mbi praninë e ish-pjesëtarëve të Sigurimit të shtetit në institucionet qëndrore dhe administratën publike.....	63

6. PARTNERITETE

6.1 Partnerë vendas.....	65
6.2 Partnerë ndërkombëtarë.....	65

III. MENAXHIMI BUXHETOR

a. Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	66
b. Menaxhimi financiar.....	68

IV. PROBLEMTATIKA DHE VIZIONI PËR VITIN 2018

a. Problematika për vitin 2018.....	70
b. Vizioni për vitin 2019.....	70

II. PASQYRË PËRMBLEDHËSE E AVTIVITETIT TË ISKK GJATË VITIT 2018

i. Misioni

Misioni dhe qëllimi i punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është grumbullimi, studimi, analizimi, evidentimi i fakteve dhe informimi i publikut në lidhje me periudhën komuniste në Shqipëri (1944-1991), në të gjitha aspektet e tij. Sipas nenit 5, të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, detyrat e këtij instituti janë:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;
- ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;

g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;

gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;

h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri; i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;

j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;

k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja

ii. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit

Gjatë vitit 2018, në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me kërkesat e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2017”, ky Institut e ka zgjeruar aktivitetin e tij dhe e konsoliduar atë përmes projekteve aftagjatë, me një vizion të qartë për vitet në vijim dhe me një menaxhim më efikas të burimeve njerëzore dhe buxhetit.

Konkretisht, i kategorizuar sipas pikave të Rezolutës, veprimtaria e vitit 2018 mund të përmbledhet në këtë mënyrë:

1. Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të vazhdojë informimin e të rinjve të shkollave të mesme mbi periudhën e regjimit komunist në të gjithë territorin e vendit. (Rezoluta)

Gjatë vitit 2018, ISKK realizoi një seri prej tetë bisedash nëpër shkolla. Por ndryshe nga viti që shkoi, bisedat u shtrinë edhe në shkolla tetëvjeçare dhe universitete, duke e konsideruar këtë si një mundësi për zgjerim audience e veçanërisht për inkurajimin e punës studimore mbi një tematikë të tillë. Veçanti tjetër e projektit arsimor të këtij viti ka qenë edhe ndërthurja e leksioneve mbi komunizmin me vizitat në muze, siç qenë dy takime të tilla në Muzeun “Shtëpia e gjetheve” në kryeqytet apo në kuadër të Shkollës Verore në Fakultetin e Historisë, në Universitetin e Tiranës, duke e bërë më tërheqëse dhe më të prekshme temën e komunizmit për këtë brez. Gjatë këtyre takimeve, përveç informimit të përgjithshëm, janë promovuar edhe botimet apo produktet e reja të ISKK. Një tjetër risi gjatë vitit 2018, ka qenë edhe zgjerimi i territorit të aktivitetit në universitete dhe biblioteka në Kosovë, duke ngacmuar interesin e studjuesve të rinj në anën tjetër të kufirit. Aktualisht, katër aktivitete të tilla janë realizuar në Kosovë, në formë takimesh informuese apo konferencash shkencore.

Duke marrë në konsideratë përvojën e një viti më parë, gjatë vitit 2018, ISKK është përpjekur të gjejë qasje alternative, më efikase, forma të reja të komunikimit me studentët. Paralelisht me programin e takimeve nëpër shkolla, ne kemi prodhur mjete audio-vizuale, montazhe filmike, dhe së fundmi filmin e parë dokumentar në 3D mbi kampin e Tepelenës, që pritet të ketë një impakt të menjëhershëm dhe të gjërë veçanërisht tek ky brez, përmes bisedave konkrete apo internetit.

Jo më pak e rëndësishme lidhur me subjektin, është edhe shpërndarja falas e gjithë botimeve të ISKK nëpër bibliotekat e shkollave të mesme që është gjithashtu pjesë e marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si edhe në bibliotekat e të gjitha rretheve.

2. Të evidentojë dhe të studiojë mekanizmat e kontrollit absolut të ish- regjimit komunist në të tria pushtetet: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si mënyrë për të kuptuar natyrën e totalitarizmit dhe impaktin në strukturën social- kulturore të shoqërisë gjatë periudhës së regjimit komunist. (Rezoluta)

Ky aspekt karakterizues i regjimit komunist në Shqipëri, materializohet në forma të ndryshme në një seri projektesh të ISKK gjatë vitit 2018. Më konkretisht:

- Botimi i studimit “Komiteti Ushtarak i Delvinës”, që është edhe vëllimi 5 i serisë “Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri”, pasqyron në mënyrë të detajuar kontekstin të persekutimit gjatë viteve 1947-1948 të të ashtuquajturit “Komiteti Ushtarak Klandestin” të Regjimentit 7 të Delvinës. Ky proces i montuar politik, nga Sigurimi i Ushtrisë në qendër dhe në Regjiment drejtuar nga Koçi Xoxe, nën udhëzimet Enver Hoxhës kishte si qëllim të terrorizonte radhët e ushtrisë në jugun e vendit, duke dënuar ushtarakët nacionalistë apo që kishin ardhur me misionin amerikan nga Bari, si Alush Sejko. Libri është i ndarë në tre kapituj; Kapitulli i parë: “Procesi Hetimor”, Kapitulli i dytë: “Procesi i Gjykimit”, Kapitulli i tretë: “Përpunime të Sigurimit dhe Rihapja e Çështjes”, Apendiksi.

- Asistencë informacioni për organet ndërkombëtare të drejtësisë.

Gjatë muajve dhjetor 2018 - shkurt 2019 nga ISKK i është përgjigjur kërkesës për informacion të fondacionit shtetëror gjerman "Justitia et Pax" mbi ish komandantin e policisë të kamp-burgut politik të Qafë - Barit (1982-1984) Edmond Caja (tani qytetar gjerman me azil politik), mandej dhe komandant i këtij kamp-burgu (1984-1989).

- Informimi i publikut mbi praninë e ish-pjesëtarëve të Sigurimit të shtetit në institucionet qëndrore dhe administratën publike (Në zbatim të detyrave të përcaktuara nga Ligji 10242, datë 25.02.2010, neni 5, shkronja "f", në akord me të cilën ISKK "vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave").

- Botimi i volumit të shtatë të serisë “Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist”, i cili pasqyron jo vetëm format e dënimeve, por edhe akt-akuzat dhe vendimet gjyqësore të individëve të përfshirë në këtë studim.
- Botimi i vëllimit të pestë “Zërat e kujtesës”, që është një transkriptim i dëshmive të persekutimit komunist, në të cilin pasqyrohen përvoja individuale me Ish Sigurimin e Shtetit, proceset e hetuesisë, gjyqet dhe prapaskenat e tyre, dënimet pa gjyq, roli i operativëve të Sigurimit në kampet e internimit, roli i Sigurimit në përçarjen e njerzve nëpër burgje, metodat e presionit fizik dhe psikologjik, etj.
- Në tetë botimet e tjera të ISKK, gjashtë prej të cilëve janë të natyrës së memuarit, pasqyrohen forma specifike të ndërhyrjes së Sigurimit të Shtetit në jetën e individit.
- Video-regjistrimet e dëshmive gjatë vitit 2018, të cilat arrijnë në 54 orë, sjellin forma të ndryshme të përvojës me Sigurimin e Shtetit dhe me drejtësinë komuniste. Spikasjin përvojat në hetuesi, dhe presioni për bashkëpunim.

3. Botimet e përgatitura nga ISKK- ja tu nënshtrohen analizave paraprake dhe miratimit nga bordi shkencor i ISKK- së, përpara botimit të tyre. (Rezoluta)

Gjatë vitit 2018, ISKK botoi 12 libra: 5 botime studimore/ dokumentuese, 6 botime memuarisike, dhe 1 literaturë nga burgjet dhe kampet. Për secilin prej tyre, është ndjekur e njejta procedurë, sipas së cilës, të gjithë tekstet e propozuar për botim, i parashtrihen Bordit Ekzekutiv dhe Bordit Akademik. Pas një shqyrtimi të hollësishëm, dy bordet përzgjedhin tekstet që ata ndjejnë të përshtatshëm për botim, në përputhje me kriteret e përcaktuara që në fillim sipas objektit të ISKK, dhe në përputhje me buxhetin vjetor. Edhe gjatë vitit 2018, botimet iu nënshtroan kësaj procedure. Prioriteti që iu dha botimeve memuaristike vitin që shkoi, ka të bëjë me cilësinë dhe impaktin që ata priten të kenë tek audienca, veçanërisht tek brezi i ri.

4. Të kryejë studime të tipologjisë së metodave të veprimit të ish- Sigurimit të Shtetit, survejimi, nënshtimi psikologjik dhe moral i qytetarëve, në bashkëpunim me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit. (Rezoluta)

Gjatë vitit, është punuar edhe në kërkimin dhe përpunimin e dokumentacionit të marrë nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit, mbi këto projekte:

- *Zbardhja e dokumentacionit të Kryengritjes së Zhapokikës;*
- *Përpunimi i dokumentacionit mbi “Komitetin Ushtarak të Delvinës”,*
- *“Nikollë Dakaj, mes perkthimit dhe proceseve politike” monografi. Kronologji e platformave politike, të Sigurimit të shtetit, dhe të DMP sipas Historikut së Armës të Sigurimit Shtetit*
- *Bibliografi e vdekjeve në kampet e Kënetës së Maliqit*

Ndërkohë, nga Drejtoria e Arkivës i është bërë kërkesë *Autoritetit të Informimit* për Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për dosjet e mëposhtme, por nuk ka marrë akoma përgjigje:

- *Arkivi i ish Sigurimit të shtetit, vitet 80. Urdhër i ish-ministrit të Brendshëm Hekuran Isai*
- *Dosje formulare 5076 nga arkivi i Ministrisë së Brendshme.*
- *Platforma e sigurimit e vitit 1948, 1958, 1986, 1987; Historiku i Sigurimit*
- *Dosje nga arkivi i Ministrisë së Brendshme: Fondi 4 (Shtabi)*

5. Të konsolidojë bashkëpunimin me AIDSSH-në, me fokus të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me aksesimin e arkivave nga të dyja institucionet. (Rezoluta)

Përveç projekteve të mësipërme, ISKK ka bashkëpunuar me AIDSSH në pesë konferenca shkencore përmes kumtesave dhe pjesëmarrjes aktive në debate. Ndërkohë ISKK i ka ofruar AIDSSH botimet, skicat e Kampit të Tepelenës për aktivitete sensibilizimi, dhe çdo gjë që është kërkuar prej AIDSSH. Por duke pasur parasysh misionin dhe natyrën e punës së dy institucioneve, bëhet e qartë që është AIDSSH institucioni që pritet të ushqejë me informacion institucionet kërkimore, dhe jo e kundërta. Dhe siç e përmendëm më sipër, AIDSSH, ndoshta për shkak të ngarkesës, nuk na është përgjigjur në kohë për kërkesat që ne u kemi paraqitur gjatë vitit që shkoi, duke shtyrë afatin e zbatimit të disa projekteve tona kërkimore.

6. Të vazhdojë informimin, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve akademike, botimeve, medias dhe rrjeteve sociale. (Rezoluta)

Një nga prioritetet e vitit 2018, ka qenë rritja e aksesit të publikut në produktin e ISKK. Ndaj një pjesë e mirë e energjisë, është fokusuar në gjetjen e formave dhe mjeteve që kanë impakt të shpejtë, të gjërë dhe të fuqishëm tek publiku, pa kufizim. Aktivitete të tilla janë:

- Realizimi i filmit “Muzeu virtual i Kampit të Tepelenës”. Ky është filmi i parë dokumentar i ciklit të muzeve virtuale, që është një nga projektet afatgjatë të ISKK. Dokumentari bazohet mbi xhirimet aktuale të gjendjes së sotme në cilësinë 4K dhe ri-krijimin e atij kampi me anë të grafikës 3D. Ky projekt, synon të krijojë vizualisht vendet e vuajtjes (burgjet dhe kampet e internimit), duke përdorur gjurmët ekzistuese dhe teknikat dixhitale. Ndërkohë, ka filluar puna kërkimore për “Muzeun virtual të kampit të Punës në Maliq” dhe për “Muzeun virtual të Burgut të Ballshit”
- Krijimi i tre video-montazheve më dëshmitë më domethënëse të krimeve të komunizmit në Shqipëri dhe shpërndarja e tyre për qëllimi informimi dhe didaktike.
- Puna kërkimore për ekspozitën online “PARA dhe PAS”, e cilat materilizohet gjatë vitit 2019.
- Digjitalizimi i botimeve të Institutit, dhe botimi i tyre online për një mundësi të pakufizuar aksesi.

- Përdorimi në masë i rrjeteve sociale.
- Angazhimi në media: gjatë vitit që shkoi, numërohen 16 artikuj, intervista, debate televizive, nga ana e ISKK ne media. të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e Institutit. Ndërkohë, konferencat dhe botimet, kanë gjetur një pasqyrim të vazhdueshëm në media.
- Hartimi i një Draft-Projekt Propozimi drejtuar Parlamentit mbi dekomunistizimin e simbolikës në hapësirën publike.
- Hartimi i akteve zyrtare mbi ruajtjen e trashëgimisë materiale të komunizmit në Shqipëri.

7. Të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e institucionit, përmes zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet e tjera, universitete dhe qendrat studimore. (Rezoluta)

Një nga pikat më të forta të aktivitetit gjatë vitit 2018 të ISKK, ka qenë zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet vendase, përmes konferencave të përbashkëta, pjesëmarrjes në konferenca, pjesëmarrjes në workshope dhe trajnime, shkëmbimit të informacionit, dhe bashkërendimit të aktiviteteve.

Konkretisht, vitin që shkoi, ISKK realizoi 10 konferenca apo tubime, dhe secila prej tyre, ishte një formë bashkëpunimi me institucione të tjera që i shërbejnë transparencës së të shkuarës komuniste, me qendrat arsimore ose me pushtetin lokal. Ndërkohë, ISKK i është përgjigjur çdo thirrjeje për bashkëpunim nga institucione të tjera, si angazhim në 12 konferenca të tjera. Në këto bashkëpunime, siç pasqyrohet në mënyrë të zgjeruar edhe në raport, mund të përmenden: Muzeu “Shtëpia e gjetheve”, Fondacioni “Drejtësi dhe paqe”, “Institutit për Demokraci, Media dhe Komunikim”, “Institutit i Studimeve Lumo Skendo”, “Autoriteti për Hapjen e Dosjeve të Sigurimit të Shtetit”, shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë në Tiranë dhe rrethe, Arkiva online KUJTO, Akademia e Shkencave, Biblioteka Kombëtare, Universiteti i Tiranës, Universiteti European i Tiranës, Universiteti Bedër, Universiteti i Elbasanit, Bashkia e Librazhdit, etj. Ndërsa bashkëpunimi me Institutin e Integritetit të Ish Përndjekurve Politikë, konsiston prej vitesh veçanërisht në shkëmbimin e informacioni (dokumentacionit) për arkivën ose dabaze-n, projekt i cili konkretizohet në serinë e botimeve “Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit në Shqipëri”.

Ndërkohë, siç përshkruhet në raport, përveç intership-it, ISKK ka ofruar bazë studimore për studentët studentë në Master apo Doktorantë, dhe ka udhëhequr katë tema diplome. Ka bashkëpunuar edhe me aktivistë socialë dhe media, për përgatitjen e filmave dokumentarë duke i ofruar dokumentacion dhe kontakte.

Pjesë e bashkëpunimit është edhe shkëmbimi i ekspertizës. Gjatë vitit që shkoi, ISKK trajnoi 3 punonjës në Muzeun “Shtëpia e gjetheve”, dhe katër punonjës të tjerë në një workshopin ndërkombëtar të organizuar nga Arkiva online KUJTO.

8. Të ndërkombëtarizojë historinë e komunizmit në Shqipëri, përmes zgjerimit të rrjetit të aktiviteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë.(Rezoluta)

Gjatë vitit 2018, ISKK ka qenë pjesëmarrëse në 7 aktivitete ndërkombëtare, të mbajtura në Shqipëri ose jashtë. Gjatë këtyre aktiviteteve ISKK, ka ofruar përvojën e saj, në çështje të tilla si: përdorimi i dokumentacionit në epokën digjitale, përdorimi i dosjeve të Sigurimit të Shtetit, dekomunistizimi i shoqërisë, menaxhimin i trashëgimisë materiale të komunizmit, etj.

Krahas forcimit të bashkëpunimit me institucionet homologe të memories dhe partnerëve të huaj me të cilët ne tashmë kemi një histori bashkëpunimi, gjatë 2018, ISKK u pranua si anëtare në rrjetin ndërkombëtar të institucione të kujtesës “Platform of European Memory and Conscience”. Gjatë vitit 2019, planifikojmë të jemi pjesëmarrës në aktivitetet e këtij rrjeti ndërkombëtar.

Ndërkohë, për një akses të mundshëm nga ana e institucioneve të huaja në përmbajtjen e produkteve të ISKK, gjatë vitit 2019, realizuam përkthimin në anglisht të dy projekteve filmike: një filmi në formë video-monazhi, dhe filmit dokumentar në 3D “Muzu virtual i Kampit të Tepelenës”.

9. Të pasurojë database- in me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri, në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t’i bëjë të aksesueshme për qytetarët (Rezoluta)

Gjatë vitit që shkoi, u realizua përpunimi i 62 mijë dokumenteve elektronike dhe zbardhja e një serie tjetër dosjesh për katër studime të ndryshme. Sipas planit vjetor, një pjesë e punës konkretizohet në serinë “Fjalor enciklopedik i terrorit komunist”, dhe gjatë vitit 2018 u botua volume i VII-të i kësaj serie. Këtu përmbledhen të tria kategoritë e përmendura më sipër: ekzekutim, burg, internim, madje edhe dëbim. “Fjalor enciklopedik i terrorit komunist”, është i aksesueshëm nga të gjithë, në versionin PDF në faqen elektronike të Institutit,

Një arkivë tjetër dinamike të dhenash, përbën projekti i dëshmime gojore në formë video-regjistrimesh. Informacionet e reja që vijnë nga ky projekt, i nënshtrohen verifikimit dhe plotsimit përmes kërkimit në arkiva.

iii. Konkluzione

Pra, gjatë vitit 2018, veprimtaria e ISKK konsistoi në:

- Informimin e të rinjve të shkollave të të gjitha niveleve mbi periudhën komuniste, në aspektin politik, social-ekonomik dhe kulturor.
- Qartësimin dhe pasurimin e ngjarjeve historike që lidhen me aktet gjyqësore politike gjatë periudhës 1947-1948, dhe proceset e fabrikimit të të ashtuquajturave “grupe armiqësore” në Ushtri.
- Evidentimin e krimeve, akteve të dhunshme, të kryera nga levat e Sigurimit të Shtetit dhe organet e tjera të komanduara të regjimit, veçanërisht në burgjet dhe kampet gjatë periudhës 1975-1985.
- Zgjerimin e informacionit mbi krimet e komunizmit në Shqipëri përmes dëshmime të të mbijetuarve, memuareve, dhe ditareve.
- Njohjen me trashëgiminë materiale të komunizmit dhe mbrojtjen, konservimin e saj, përmes projektit të muzeve virtualë të kampeve dhe burgjeve dhe ekspozitës online.
- Sensibilizimin mbi mbrotjen e trashëgimisë materiale të komunizmit si një element i domosdoshëm i kujtesës kolektive.
- Gjetjen e mënyrave efikase të memorizimit të së shkuarës komuniste përmes projekteve filmike, audio-vizuale, dhe përdorimit të teknologjive dixhitale.
- Zgjerimin e informacionit mbi sistemin e internim-dëbimeve dhe punën e detyruar në Shqipëri.
- Zgjerimin e database-s mbi krimet e komunizmit në Shqipëri përmes dëshmime të të mbijetuarve, memuareve, dhe ditareve.
- Rritjen e impaktit publik mbi historinë e komunizmit në Shqipëri, përmes projekteve interaktive.
- Rritjen e aksesit publik mbi historinë e komunizmit në Shqipëri, përmes publikimit online të studimeve të këtij Instituti.
- Rritjen e aksesit publik përmes promovimit të gjërë të veprave të ISKK dhe shpërndarjes së tyre falas në të gjitha bibliotekat e vendit
- Informimin dhe rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve akademike, botimeve, medias dhe rrjeteve sociale.

- Pasurimin me fakte dhe nxitjen e debatit shkencor dhe mediatik në lidhje me kampet me tela, si forma monstruoze të trajtimit të grave, të moshuarve, dhe sidomos të miturve.
- Evidentimin e keqtrajtimit të të moshuarve, dhe të paaftëve për punë, në kampet-burgje.
- Denoncimin e ilegjitimitetit të masës së internimit për të miturit.
- Evidentimin e kultit të individit të krijuar nga diktatori përmes falsifikimit të historisë dhe mjeteve të propagandës.
- Thellimin e bashkëpunimit me institucione të tjera homologe jashtë vendit, përmes shkëmbimit të ekspertizës.
- Denoncimit e rasteve të përdorimit të simbolikës komuniste në vende publike.
- Rritjen e efikasitetit të aktivitetit të Institucionit, përmes zgjerimit të bashkëveprimit me institucionet të tjera, universitete apo qendra studimore.
- Ndërkombëtarizimin e historisë së komunizmit në Shqipëri, përmes zgjerimit të rrjetit të aktiviteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë.
- Pasurimin e database-s me të dhëna statistikore dhe cilësore të viktimave të komunizmit në Shqipëri, në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim.
- Interpretimin e situatës politike që sollti në pushtet komunistët, duke iu dokumenteve të deklasifikuara të Shërbimit Inteligent Britanik (SOE) në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Dokumentimin e formave të izoluar të rezistencës antikomuniste, shtypjen dhe ndëshkimin që i pasoi.
- Analizimin e ngjarjes së ndëshkimit masiv mbi popullsinë e Mirditës, të njohur si “Masakra e Mirditës”, nën dritën e fakteve të reja.
- Evidentimin e rasteve të reja të kthimit të të arratisurve politikë, si rezultat i marrëveshjeve të fshehta midis Shqipërisë dhe shtetit jugosllav.
- Evidentimin e rasteve të reja të përvetësimit të paligjshëm të pronës të individit nga shteti komunist.

- Plotësimin e hartës së veprave industriale dhe bujqësore të ndërtuara me punën e të burgosurve politikë dhe përshkrimin e kushteve në këto kampe pune.
- Krijimin e një tipologjie të metodave të veprimit të ish-Sigurimit të shtetit;urvejimi, nënshtrimi psikologjik dhe moral i qytetarëve.
- Evidentimin e rasteve të reja të dhunës fizike dhe kushteve mizore të trajtimit në hetuesi.
- Evidentimin e përçarjeve që krijoi e ashtuquajtura ‘Luftë e klasave’, dhe roli i organizatave të masave në këtë përçarje të popullsisë.
- Evidentimin e rezistencës morale dhe kulturore nëpër burgje, kampe dhe kushte të tjera privimi.

III. AKTIVITETET

1. PROJEKTE

1.1 PROJEKTE EDUKUESE

“Komunizmi në Shqipëri: fantazi apo realitet?”

TITULLI I	“Komunizmi në Shqipëri: fantazi apo realitet?”
-----------	--

PROJEKTIT	<i>Seri leksionesh dhe bisedash me karakter informues, edukues dhe sensibilizues mbi historinë e hidhur të komunizmit në Shqipëri, me nxënësit e shkollave të të gjitha niveleve të arsimit publik dhe jopublik.</i>
LLOJI I PROJEKTIT	Projekt afatgjatë
KOHËZGJATJA E GJITHË PROJEKTIT	1 nëntor 2016- 1 maj 2021
PËRMBAJTJA	<p>Përshkrimi i projektit</p> <p>Në vijim të konkretizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me datë 21 tetor 2014, midis Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Shqipërisë, marrëveshje e cila ka si qëllim koordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale që synojnë edukimin e nxënësve dhe studentëve dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi krimet e komunizmit, ISKK duke ndjekur edhe përvojën e gjithë institucioneve homologe të kujtesës në Europë, hartoi një projekt afatgjatë të titulluar “Komunizmi në Shqipëri: fantazi apo realitet?”</p> <p>Projekti bazohet në testimin e njohurive të të rinjve mbi dramën e komunizmit në Shqipëri dhe veçanërisht informimin e tyre, përmes një serie bisedash të zgjeruara nëpër shkollat publike. Në përmbajtjen e tyre, këto takime, ofrojnë informacion të dokumentuar mbi aspektet më të rëndësishme të kësaj epoke, si: persekutimi politik, ekonomia komuniste, roli i propagandës, etj. Takimet janë të konceptuara si leksione të hapura & bashkëbisedim midis ekspertëve dhe audiencës, duke përdorur forma interaktive, si: foto, dokumente, filma, video-regjistrime etj.</p> <p>Qëllimi i projektit</p> <p>Qëllimi i këtij projekti afatgjatë është që përmes informimit të brezit të ri mbi dramën e komunizmit në Shqipëri dhe pasojat e kësaj epoke në të sotmen dhe të ardhmen e vendit, të edukojë tek ata kulturën demokratike dhe sensin e përgjegjësisë në shoqëri.</p> <p>Objektivat e projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informim i përgjithshëm mbi realitetin komunitet në Shqipëri nga 1944-1991. - Informimi mbi fillesat e komunizmit dhe instalimin e sistemit totalitar në Shqipëri.

- Informimi mbi shkatërrimin e sistemit të drejtësisë.
- Informimi mbi reformat ekonomike komuniste: sekuestrimet, zhdukja e pronës private dhe krijimi i ekonomisë kolektive. Prona shtetërore dhe kooperativat bujqësore
- Informimi mbi burgjet, kampet e internimit dhe kampet e punës
- Informimi mbi mekanizmin dhe rolin e propagandës komuniste
- Informimi mbi diskriminimin mbi baza politike në të gjitha nivelet
- Informimi mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit komunist
- Nxitja e një debati publik në shkolla dhe më gjërë mbi këtë temë.

Pritshmëritë e projektit:

1. Informimi gjërësisht i mijëra të rinjve të shkollave të mesme dhe universiteteve, mbi dramën e komunizmit dhe pasojat në realitetin e sotëm.
2. Inkurajimi i iniciativave individuale, në grup ose në rrang shkolle, për reflektimin mbi të shkuarën komuniste.
3. Nxitja dhe inkurajimi i stafit pedagogjik të shkollave, për lëvrimin e kësaj teme në lëndë të ndryshme brenda programit mësimor.
4. Rritja e ndjeshmërisë publike dhe institucionale përmes marrëdhënieve nxënës-mësues, nxënës-prindër, pas realizimit të bisedave dhe debatit në shkolla.
5. Nxitja e reformave për modifikimin e teksteve ose krijimin e altermekteve shkollore, të cilat pasqyrojnë gjërësisht dhe në mënyrë shkencore, realitetin komunist në Shqipëri.

Grupi i punës

Agron Tufa, Çelo, Hoxha, Luljeta Lleshanaku, Leka Ndoja, Alvin Saraçi
Koordinator: Miran Butka

Partnerët

- Ministria e Arsimit të Shqipërisë
- Universitetet publike dhe private
- Muzeu “Shtëpia e gjetheve”

**AKTIVITETET E
REALIZUARA
GJATË VITIT
2018**

Ndërsa gjatë vitit 2017 aktiviteti i ISKK u përqëndrua në shkollat e mesme publike të qytetit të Tiranës, gjatë vitit 2018, ky aktivitet u zhvendos kryesisht në universitete publike dhe private në Tiranë dhe më gjërë, ose u alternua me atë institucioneve të tjera të memories, si Muzeu “Shtëpia e gjetheve”.

KALENDARI I AKTIVITETEVE

15 mars 2018: Bisedë në Museun “Shtëpia e gjetheve”

Pas një seminari një- ditor të organizuar nga Muzeu “Shtëpia e gjetheve” në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë për informimin e të rinjve mbi historisë e persekutimit komunist në Shqipëri, Luljeta Lleshanaku, Drejtore e Studimeve në ISKK, u ftua për të mbajtur një bisedë informuese me nxënësit e shkollës “Fan Noli” në Tiranë, si pjesë e programit të vizitës në këtë Muze.

23 prill 2018: Bisedë në Fakultetin e Historisë, në UT në Ditën Ndërkombëtare të Librit

ISKK në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë në Univeristetin e Tiranës dhe me iniciativën e historianes Znj. Enriketa Pandelejmoni, në ambjentet e këtij Fakulteti, u zhvillua një bisedë me temë “Krimet e komunizmit dhe projeksoni i tyre në literaturën e viteve të fundit”, ku u bë edhe prezantimi i kolanës së botimeve të ISKK gjatë vitit 2017. Agron Tufa, drejtor ekzekutiv i ISKK dhe përgjegjës i botimeve, në ligjeratën e tij, bëri një rezymë të historisë së komunizmit në Shqipëri dhe trajtoi disa aspekte të veçanta të tij, që sot vijnë përmes studimeve shkencore. Pas njohjes së audiencës me përmbajtjen e këtyre botimeve, ligjëruesit u ndalën tek njëri prej botimeve, tek monografia "Pertej harrimit - Abdulla Rami", me autore Ermira Xhomaqin. Meqenëse autorja ishte e pranishme në takim, pjesa tjetër e takimit u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi të autores me audiencën e studentëve dhe pedagogëve pjesëmarrës.

25 prill 2018: Bisedë në Universitetin Publik “Kadri Zeka” të Gilanit.

Me ftesë nga Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gilan, ISKK zhvilloi një takim me sududentët dhe pedagogët e këtij universiteti ku Drejtori Ekzekutiv i ISKK Agron Tufa, mbajti një ligjeratë me temë “Komunizmi në Shqipëri” ku u ndal edhe në linjën e trajtimit të çështjes shqiptare nga politika zyrtare e shtetit komunist, bazuar mbi dokumentacionin dhe studimet e deritanishme. Në sezonin e fundit të takimit u bë prezantimi i monografisë "Pertej harrimit - Abdulla Rami", me prezencën e autores Ermira Xhomaqi, nisur nga kontributi i Z.Abdulla Rami për çështjen e Kosovës gjatë Luftës, para se të burgosej nga regjimi i Tiranës.

27 prill 2018: Bisedë në Universitetin publik “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan

Në bashkëpunim Universitetin publik "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit, ISKK realizoi një takim me studentët dhe pedagogët e këtij universiteti, me temë krimet e komunizmit. Drejtori ekzekutiv i këtij Instituti, bëri edhe një përmbledhje të botimeve të tij në lidhje me transparencën e së shkuarës komuniste, duke u fokusuar në librin "Përtej harrimit - Abdulla Rami", të Ermira Xhomaqit, si një mundësi për audencën për të komunikuar drejtpërdrejtë me autoren, të pranishme në takim.

30 prill 2018: Bisedë në Universitetin jopublik "UET", në Tiranë

I ftuar nga Universiteti Europian i Tiranës, Drejtori i ISKK z.Agron Tufa, zhvilloi një takim me studentët dhe pedagogët e Universitetin jopublik UET, ku u mbajtën ligjërata dhe kumtesa, u promovuan botimet e fundit të ISKK, dhe u ndalur në librin "Përtej harrimit - Abdulla Rami", të Ermira Xhomaqit, me praninë e autores në sallë.

1 Qershor 2018: Bisedë në Muzeun “Shtëpia e gjetheve”

Si pjesë e një projekti bashkëpunimi të Muzeut “Shtëpia e gjetheve” me Zyrën e OSBE në Tiranë për informimin e të rinjve mbi krimet e komunizmit në Shqipëri, Luljeta Lleshanaku, Drejtore e Studimeve në ISKK, u ftua për të mbajtur një bisedë informuese me nxënësit e shkollës “Misto Mame”, si pjesë e programit të vizitës në këtë Muze.

11 korrik 2018: Cikël aktivitetesh i ISKK në kuadër të “Shkollës verore”, në Universitetin e Tiranës

ISKK në bashkëpunim me Dr. Enriketa Pandelejmonin në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Tiranës, udhëheqëse e projektit të Shkollës Verore me studentë e studiues të Historisë, realizoi një cikël aktivitetesh rreth Krimeve të Komunizmit. Në program ishin përfshirë:

- a) Leksion i Drejtorit të ISKK me temë "E vërteta, dokumenti, interpretimi rreth krimeve të komunizmit. Si duhen trajtuar debatet rreth mohimit të krimeve të komunizmit.
- b) Shfaqja e filimit dokumentar "Dyert memecë të Ferrit", produksion i ISKK.
- c) Përgjigje pyetjeve nga auditori dhe diskutime.

22 tetor 2018: Dita Kombëtare e Aktivizmit 2018 (NAD)

	<p>Në Ditën Ndërkombëtare të Aktivizmit (NAD), ISKK në bashkëpunim me organizatën MEMO dhe fondacionin KUJTO, u përfaqësuan me një stendë të përbashkët në panairin një-ditor të krijuar me këtë rast. NAD u caktua si një ditë dedikuar njerëzve dhe nismave që guxojnë dhe përfshihen për të përmirësuar gjërat që shqetësojnë shoqërinë. Në këtë panair, ISKK u prezantua me botimet e veta ndër vite.</p> <p>Pjesë e këtij aktiviteti, qe edhe një bisedë publike, që një grup përfaqësuesish të këtyre organizatave, dhanë për gjimnazet e Tiranës, lidhur me rolin e kujtesës së krimeve të komunizmit tek brezi i ri shkollor në kushtet e mungesës së pasqyrimin të historisë sonë të diktaturës në kurrikulat mësimore. Folën Agron Tufa drejtor ekzekutiv i ISKK, Gjon Radovani, Agron Shehaj dhe Ardita Repishti. Natyra e takimit ishte bashkëbiseduese, me pyetje e përgjigje.</p>
--	---

1.2 PROJEKTET DËSHMUESE

1.2.1 Krijimi i arkivës audio-vizuale të dëshmime të ish të përndjekurve politikë

TITULLI I PROJEKTIT	<p>KRIJIMI I ARKIVËS AUDIO-VIZUALE TË DËSHMIVE TË ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË</p> <p>Seri video-regjistrimesh me rrëfimet e vuajtësve të drejtëpërdrejtë dhe dëshmitarëve të krimeve të komunizmit në Shqipëri</p>
LLOJI I PROJEKTIT	Projekt afatgjatë
KOHËZGJATA E PROJEKTIT	2012-2023
PËRMBAJTJA	<p>Përshkrimi i projektit</p> <p>Një nga prioritetet e ISKK prej fillimi, ka qenë mbledhja e dëshmime të të mbijetuarve të persekutimit komunist, dhe krijimi i një arkive audio-vizuale e cila do të shërbente si bazë kërkimore për studjuesit, por edhe do të publikohej në forma të ndryshme: botime, filma, muze, media. Në mungesë të evidencave zyrtare, ky projekt plotëson një hallkë shumë të rëndësishme në rikompozimin, rishkrimin e historisë së krimeve të Komunizmit, sidomos në aspektin cilësor. Në momentin që po flasim, për fat, janë akoma midis nesh mijëra të mbijetuar nga burgjet, kampet e</p>

punës, kampet e internimit, pa llogaritur pasardhësit e tyre, të cilët, edhe nëse nuk pësuan fatin e ashpër të të parëve, provuan padrejtësi të tjera në emër të tyre. Dhe ky kontigjent, përbën edhe bazën më të rëndësishme të informacionit mbi historinë e komunizmit në Shqipëri, ose anën e pashkruar e të palegjitimuar akoma, të kësaj historie.

Elie Wiesel, i mbijetuari i tri kampeve të përqëndrimit (Auschwitz, Buna, dhe Buchenwald), shkrimtar dhe fitues i Çmimit “Nobel” për Paqe në vitin 1986, duke iu referuar të mbijetuarve të holokaustit, thotë se “çdo i mbijetuar ka shumë më tepër se çfarë të thotë për atë që ka ndodhur, se të gjithë historianët bashkë.” Dhe në një kohë, kur numri i të mbijetuarve sa vjen dhe po zvogëlohet (për shkak të moshës dhe për shkak të emigrimit), mosmarrja në kohë dhe në mënyrë urgjente e këtyre dëshmimeve, rrezikon misionin e ISKK-së për zbardhjen dhe rishkrimin e historisë së krimeve të komunizmit, përmes një procesi transparence historike dhe gjykimi objektiv të ngjarjeve.

Ky projekt konkretisht konsiston në videoregjistrimin e intervistave me të mbijetuarit e burgjeve dhe kampeve të komunizmit. Projekti bazohet në përshkrimin cilësor më tepër se atë statistikor të ngjarjeve, i cili vjen përmes rrëfimit të përvojave, ku detajet, situatat konkrete, konteksti, personazhet realë të përfshirë në to, e bëjnë jo vetëm të pakontestueshme përvojën individuale, por, ndihmojnë edhe në plotësimin e kornizës së plotë të ngjarjeve. Si i tillë, ky projekt, më shumë se çdo iniciativë tjetër, krijon antropologjinë e regjimit komunist në Shqipëri.

Duke filluar që nga viti 2012, ISKK ka arritur të realizojë mbi 300 orë videoregjistrime.

Procesi i realizimit të video-regjistrimeve, kalon nëpër këto faza:

- Përzgjedhja dhe kontakti me të intervistuarit
- Informimi i të intervistuarit mbi natyrën e projektit, dhe se çfarë kërkohet prej tij.
- Intervistimi (disa orësh, me ose pa ndërpreje)

Metodologjia:

Përzgjedhja e të intervistuarve bëhet sipas këtij kriteri: të intervistuarit duhet të jenë vuajtës të drejtëpërdrejtë ose dëshmitarë të ngjarjeve të cilat rrëfejnë. Lidhur me metodologjinë e marrjes së këtyre dëshmimeve, është ndjekur modeli i intervistave të gjata disa-orëshe, pa pyetje përgatitore, duke ia lënë kështu vendin një rrëfimi të gjatë e të pasur me detaje, dhe krejt spontan. Emrat e individëve, dëshmitarëve të tjerë, vendeve, koha, përbëjnë një element mjaft të rëndësishëm në riskicimin e ngjarjes. Gjatë rrëfimit bëhen ndërhyrje vetëm për saktësimin e detajeve. Ndërkohë,

intervistuesi është krejt i lirë të deklarojë ose jo emra, ose rrethana.

Akoma mbetet problematike marrja e dëshmive në zonat e largëta, për shkak të mundësisë së kufizuar logjistike të lëvizjes në terren.

Pas realizimit të videore-regjistrimeve, sipas një plani vjetor botimi, një pjesë e intervistave transkriptohen dhe përgatiten për shtyp. Ky është edhe një prej rezultateve të këtij projekti.

Nga viti 2012 që filloi ky projekt, ISKK ka botuar 5 vëllime me intervista (dëshmi) të transkriptuara, në kolanën e quajtur “Zërat e kujtesës”.

Qëllimi i projektit:

Evidentimi i krimeve të komunizmit përmes rrëfimit gojor të të mbijetuarve dhe publikimi i tyre.

Objektivat

1. Krijimi i një arkive të pasur audio-vizuale të dëshmive të të mbijetuarve të terrorit komunist, si një bazë dokumentuese për studjuesit, median, dhe çdo palë të interesuar për këtë temë
2. Transkriptimi dhe botimi i këtyre dëshmive si pjesë e kolanës “Zërat e kujtesës”
3. Publikimi i tyre i pjesshëm ose i plotë në website-n e Institutit, në media dhe në median sociale.

Grupi i punës:

Agron Tufa, Luljeta Lleshanaku (intervistim)

Luljeta Lleshanaku, Miran Butka (koordinim, transkriptim, redaktim, përgatitje për shtyp)

Partnerët

- Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë
- Instituti i Integritetit të Ish të Përndjekurve Politikë

<p>REZULTATET PËR VITIN 2018</p>	<p>Gjatë vitit 2018, grupi i punës u përpoq që përmes kontakteve të arrijë të sigurojë një numër të konsiderueshëm dëshmish nga emigrantët shqiptarë dhe nga rrethet e largëta të Shqipërisë duke e zgjeruar rrezën gjeografike të projektit.</p> <p>Në aspektin cilësor, dëshmitë audio-vizuale të marra gjatë kësaj periudhë, zgjerojnë njohuritë në disa aspekte të panjohura ose të njohura fare pak deri tani, siç janë: burgu i Tales dhe dhuna e përdorur në atë burg si mënyrë terrorizimi pas revoltës së Qafë Barit; kampet e vogla dhe të përkohshme të punës; fati i fëmijëve të Kampit të Tepelenës, të cilët, me një vendim qeverie, u lanë të lirë, ndërkohë që familjet e tyre vazhdonin të mbaheshin të internuara; vetë-dëmtimi fizik i të burgosurve politikë për të shmangur me çdo kusht punën e rëndë në minierë; fati i fëmijëve të kampit të Kamzës pas shpërndarjes së familjeve në kampet e tjera të punës; rastet e degradimit psikik të personave që vuajtën kampet me tela gjatë fëmijërisë së tyre; sfida e pamundur e ri-integrimit pas daljes nga burgu; rikthimi i të arratusurve politikë për shkak të marrëdhëveshjeve të fshehta midis shtetit shqiptar dhe atij jugosllav; presioni i vazhdueshëm ndaj familjeve të të arratisurve politikë; valët e internimeve masive nga viti 1954-1990, etj.</p> <p>Në aspektin sasior, ISKK arriti që gjatë vitit 2018, të realizonte 54 orë video-regjistrime, nga të cilat 18 orë janë të realizuara në rrethe.</p>
---	---

1.2.2 Mbledhja e memuareve, ditareve, shënimeve autentike, dorëshkrimeve të ndryshme, fotografive, veprave artistike, artefakteve

Përveç krijimit të arkivës së dëshmimeve audiovizuale, Instituti ka punuar paralelisht edhe në drejtim të mbledhjes së ditareve, memuarve, korespondencës private, dhe materiale të tjera shkruara autentike, të cilat ndihmojnë në pasurimin e njohurive mbi komunizmin, në aspektet më domethënëse.

Prej dy vitesh, ISKK, përmes një njoftimi publik në website dhe rrjete sociale, dhe përmes një fushate informimi dhe sensibilizimi në aktivitete publike dhe media, ka arritur të tërheqë një bashkëpunim të konsiderueshëm në këtë pikë. Ndërsa një pjesë tjetër e punës për mbledhjen e tyre ka qenë inkurajimi i ish të persekutuarve, dhe jo vetëm i kësaj shtrese, për të shkruar përvojën e tyre që përkon me natyrën e aktivitetit tonë. Krijimi i kësaj arkive materiale do t'i mundësojë publikut të gjërë dhe studjuesve të specializuar, një bazë dokumentacioni mbi krimet e komunizmit.

Pas dorëzimit në formë maniskripti, një ekip merret me shtypjen, redaktimin dhe përgatitjen e tekstit për botim ose për përdorim në arkivë. Si rezultat, gjatë vitit 2018, në sajë të njohjes që tashmë ka krijuar veprimtaria e ISKK por edhe punës bindëse kokë më kokë, u arrit që pjesa më

e madhe e veprave të botuara të ishin memuare, ose ditare. Konkretisht nga 12 vepra të botuara, 5 prej tyre ishin pikërisht në këtë gjini.

Pjesë e kësaj fushate është edhe ndërgjegjësimi mbi artefaktet, objektet të cilat paraqesin një lloj interesi mbi simbolikën komuniste që përmbajnë. Gjatë vitit 2018 ISKK trajnoi dy specialistë një një seminar trajnimi një-ditor me një ekspert të huaj të organizuar nga Muzeu “Shtëpia e gjetheve”, që i paraprin konferencës që ISKK do të organizojë me 25 shkurt të këtij viti (2019) mbi trashëgiminë materiale të Komunizmit, me fokus artefaktet, në mënyrë që të krijohet një network organizatash që do t’i shërbejnë mbledhjes së artefakteve dhe çdo gjurmë tjetër material të trashëgimisë materiale komuniste. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi natyrën, rëndësinë, dhe ruajtjen e trashëgimisë materiale, do të jetë synimi i këtij network-u, për të arritur në rezultate të rëndësishme konkrete.

1.3 PROJEKTET DOKUMENTUESE

1.3.1 Krijimi i një database-i mbi viktimat e komunizmit

TITULLI I PROJEKTIT	KRIJIMI I NJË DATABASE-I MBI VIKTIMAT E KOMUNIZMIT
LLOJI I PROJEKTIT	Projekt afatgjatë
KOHËZGJATA E PROJEKTIT	2011-2023
KOHËZGJATJA E FAZËS SË SHITATË	Shtator 2016- shtator 2017
PËRMBAJTJA	<p>Përshkrimi i projektit</p> <p>Në vitin 1993-1995, nga Komiteti i Integritit të Ish të Përndjekurve Politikë dhe filialet e tij nëpër rrethe, u arrit të bëhej një regjistrim i individëve të persektuar në bazë të dokumentacionit mbeshitetës nga Ministria e Puneve të Brendshme, dhe Ministria e Drejtësisë. Dhe mbi këto të dhëna u bë përcaktimi i statusit të persektuarve sipas kategorive, që do të shërbente më vonë edhe si bazë dokumentuese, për shpërblimin e tyre financiar. Por, ky regjistër është i paplotë, sepse është ndërtuar në bazë të kërkesave të interesuarve, jo në bazë të një studimi shterues mbi baza shkencore. Nga kërkimet e deritanishme të ISKK, numri i të dënuarve të të gjitha kategorive, është shumë herë më i madh se shifra aktuale zyrtare. Nga ana tjetër, statisikat e deritanishme, përveçse të paplota, janë të pa-aksesueshme nga publiku.</p> <p>Një nga projektet afatgjatë të ISKK, është pikërisht krijimi i një databaze, me të dhëna zyrtare mbi të dënuarit, format e dënimeve, kohëzgjatjen e dënimeve, dhe vendimet me të cilat janë bërë këto dënime. Drejtoria e Arkivës ka ngritur një grup pune për mbledhjen, pasurimin dhe</p>

organizimin e informacionit.

Grupi i punës i ngarkuar për krijimin e database-s, mbledh informacion për personat të cilët, u dënuan politikisht që nga viti 1944 kur komunizmi u instalua, e deri në vitin 1991, me rënien e tij.

Në këtë database, përfshihen:

1. Të ekzekutuarit, të vdekurit në burgje.
2. Të burgosurit
3. Të internuarit në kampet me tela
4. Të internuarit në kampet e punës
5. Të dëbuarit.

Për hartimin e këtij database, grupi i punës i referohet:

- a. Dokumenteve të marra nga Instituti i Integritit të Ish- të Përndjekurve Politikë
- b. Dokumenteve të Ministrisë së Drejtësisë
- c. Dokumenteve të arkivës së Ministrisë së Brendshme
- d. Dokumenteve arkivore në Drejtorinë e Arkivave të Shtetit
- e. Dokumenteve të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
- f. Studimeve akademike
- g. Shtypit zyrtar të periudhës 1944-1991
- h. Fletore zyrtare
- i. Arkivave të huaja
- j. Arkivave të shoqatave shqiptare në ekzil
- k. Arkivës së Ministrisë së Jashtme
- l. Dëshmime të ish të persekuarve politike dhe bashkuvajtjsve të tyre
- m. Dokumenteve në Bibliotekën Kombëtare
- n. Studimeve akedemike të universiteteve të huaja mbi këtë temë.

Procesi i hartimit të të dhënave

Konkretizimi i kësaj baze të dhënash, kalon nëpër disa faza:

- Grumbullimi i të dhënave
- Verifikimi dhe përpunimi i të dhënave
- Pasurimi i të dhënave
- Organizimi i të dhënave në bazë indeksi
- Dixhitalizimi i të dhënave
- Programimi i aksesit publik në database-n elektronike
- Botimi i plotë i gjithë kolanës së “Fjalorit të viktimave të terrorit komunist”

Qëllimi i projektit:

	<p>Qëllimi i këtij projekti është evidentimi dhe dokumentimi i të gjithë individëve që vuajtën persekutimin politik në komunizëm.</p> <p>Objektivat e projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidentimi i plotë i të gjithë të dënuarve të ndëshkuar me ekzekutim, burgosje, internim dhe dëbim nga regjimi komunist. - Identifikimi sasior dhe cilësor i të gjitha llojeve të dënimeve të aplikuara - Krijimi i aksesit publik online në këtë database - Botimi i gjithë informacionit në një kolanë të titulluar “Fjalori i viktimave të terrorit komunist” <p>1. Grupi i punës:</p> <p>Çelo Hoxha (drejtues), Azem Qazimi, Leka Ndoja, Brunilda Doçi, Juliana Kurti, Kolë Kamsi, Ada Sinani, Daniela Runa, Alvin Saraçi, Ada Sinani, Zoica Graçi.</p>
<p>REZULTATET E PROJEKTIT PËR VITIN 2018</p>	<p>1. Projekti i Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist</p> <p>Siç u përmend më lart, puna për krimin e database-s, ka filluar me krijimin e Institutit, duke grumbulluar gradualisht të dhënat. Kërkimi i të dhënave shkon paralelisht me hartimin e “Fjalorit të viktimave të terrorit komunist”.</p> <p>Gjatë vitit 2018, Drejtorja e Arkivës realizoi vëllimin 7 të <i>Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist</i>, shkronjat Q, R, Rr, S, i cili u botua në tetor duke grumbulluar ndërkohë dokumente arkivore në lidhje me objektin e studimeve të ISKKK.</p> <p>Për këtë numër u konsultuan dhe radhitën (zbardhën) rreth 5000 dokumente: deklarata personale, vendime gjyqi, vendime të Komisionit tre palësh; këto dokumente janë grumbulluar nga punonjësit e arkivës dhe gjenden në arkivën elektronike të ISKK. Veç këtyre janë shfrytëzuar dhe materiale të botuara si gazeta, libra, etj., të cilat janë dhënë me referenca të sakta në vëllimin e botuar.</p> <p>Puna u zhvillua në dy faza: e para, përzgjedhja e dokumneteve përkatëse për vëllimin nga grupi i përgjithshëm i dokumenteve, rreth 62 mijë dokumente elektronike (dokumente origjinale të fotografuara); e dyta, dokumentet e përzgjedhura (rreth 5000) u radhitën. Proces tjetër ishte redaktimi i materialit që u bë nga dy redaktorët përgjegjës për përgatitjen e enciklopedisë.</p>

Specialistët e arkivës kanë punuar gjithashtu për gjetjen e emrave të mundshëm që nuk janë përfshirë në enciklopeditë e mëparshme, sepse, siç dihet, ne nuk i kemi pasur në dispozicion dokumentet në mënyrë shteruese, dhe në bazë të dokumenteve të reja që gjejmë, mundohemi të bëjmë plotësimet e mundshme.

Gjatë viti të kaluar kemi grumbulluar dhe një numër të konsiderueshëm në lidhje me internimet, kryesisht bazën ligjore, me synimin për përgatitjen e një vëllimi shterues në lidhje me këtë temë.

Grupi i punës:

Çelo Hoxha (redaktor), Kolë Kamsi (redaktor), Brunilda Doçi, Juliana Kurti, Daniela Runa, Ona Iliazi, Zoica Graçi

2. Projekte në proces:

Gjatë vitit, është punuar edhe në kërkimin dhe përpunimin e dokumentacionit mbi tema të caktuara:

1. *Zbardhja e dokumentacionit të Kryengritjes së Zhapokikës, të marrë nga Autoriteti i Informimit për Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit - Çelo Hoxha*
2. *Përpunimi i dokumentacionit mbi “Komitetin Ushtarak të Delvinës”, nga AQFA- Leka Ndoja*
3. *“Nikollë Dakaj, mes perkthimit dhe proceseve politike” monografi. Kronologji e platformave politike, të Sigurimit të shtetit, dhe të DMP sipas Historikut së Armës të Sigurimit Shtetit - Leka Ndoja*
4. *Kalendari bazë i krimeve të komunizmit; axhendë- Leka Ndoja*
5. *Bibliografi e vdekjeve në kampet e Kënetës së Maliqit- Leka Ndoja*

Ndërkohë, nga Drejtoria e Arkivës i është bërë kërkesë Autoritetit të Informimit për Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për këto dosje, por nuk ka marrë akoma përgjigje:

- Arkivi i ish Sigurimit të shtetit, vitet 80. Urdhër i ish-ministrit të Brendshëm Hekuran Isai
- Dosje formulare 5076 nga arkivi i Ministrisë së Brendshme.
- Platforma e sigurimit e vitit 1948, 1958, 1986, 1987; Historiku i

	<p>Sigurimit</p> <p>- Dosje nga arkivi i Ministrisë së Brendshme: Fondi 4 (Shtabi)</p>
--	--

1.4 PROJEKTE INFORMUESE-SENSIBILIZUESE

1.4.1 Muzeu virtual i komunizmit në shqipëri

TITULLI I PROJEKTIT	<p>MUZEU VIRTUAL I KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI</p> <p>-Cikël muzesh virtualë të burgjeve dhe kampeve në Shqipërinë komuniste</p>
LLOJI I PROJEKTIT	Projekt afatgjatë
KOËZGJATA E PROJEKTIT	Nëntor 2017-Nëntor 2021
KOHËZGJATJA E FAZËS SË PARË	Nëntor 2017-Nëntor 2018 (Muzeu virtual i Kampit të Tepelenës)
KOHËZGJATJA E FAZËS SË DYTË	Nëntor 2018- Nëntor 2019 (Muzeu virtual i Burgut të Ballshit)
PËRMBAJTJA	<p>Përshkrimi i përgjithshëm i projektit:</p> <p>“Muzeu Virtual i Komunizmit” është konceptuar si një muze virtual që ofron informacion historik mbi periudhën e komunizmit në Shqipëri për ndërgjegjësimin e publikut mbi krimet e komunizmit. Qëllimi i krijimit të këtij muzeu, është shpërndarja e këtij informacioni, duke kombinuar standardet e larta shkencore me një format zbavitës.</p> <p>Ky muze konsiston në xhirimin e hapësirave aktuale të ish-burgjeve dhe kampeve kryesore politike në Shqipëri duke përdorur rezolucion 4 K, dhe grafikën 3D. Informacioni vizual që sjell ky projekt bazohet mbi gjurmët e trashëgimisë materiale të epokës komuniste, kombinuar me dokumente dhe sidomos dëshmi të mbijetuarve në këto burgje dhe kampe. Këto xhirime do të shoqërohen me narracion, përmes të cilit vijnë faktet më domethënëse që krijojnë historikun e këtyre vendeve të vuajtjes, si edhe me elementë akustikë që krijojnë efektin emocional dhe psikologjik të ngjarjes. Kohëzgjatja e klipit për çdo burg ose kamp, është menduar të jetë deri në 10 minuta.</p>

Ky muze virtual është një produkt dixhital që bazohet në karakteristikat e një muzeu, në mënyrë që të plotësojë, të zgjerojë njohuritë mbi këtë temë përmes personalizimit, interaksionit dhe pasurisë së përmbajtjes.

Si me një muze tradicional, ky muze virtual projektohet rreth objekteve të veçanta (të tilla si një muze arti apo një muze natyror ose historie) që janë rrënojat e vendeve të vuajtjes, objekteve personale ose publike që lidhen me këto vende, si edhe mbi faktet e sugjeruara nga viktimat që e kanë përjetuar këtë përvojë dhe dëshmitarët okularë të ngjarjeve në këto vende, për të krijuar në mënyrë imagjinare idenë dhe emocionin mbi të shkuarën komuniste.

Muzeu do të futet në internet, në mënyrë që të ketë një akses të gjërë në publik, sidomos tek të rinjtë. Klipet do të jenë të aksesueshëm për të gjithë shikuesit në faqen zyrtare elektronike të ISKK, si edhe në youtube.

Ndërkohë faqja në të cilën do të botohet Muzeu Virtual i Komunizmit, do të vihet në lidhje me link-e të tjera insitucionesh të kujtesës, të cilat kanë një mision të ngjashëm studimi me ISKK, dhe i shërbejnë transparencës së të shkuarës komuniste.

Pse është i nevojshëm ky projekt?

Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri, me qëllimin për t'u distancuar nga e shkuara komuniste, evidentimit dhe ruajtjes së trashëgimisë materiale të komunizmit në Shqipëri, iu kushtua shumë pak vëmëndje. Si pasojë, vendet e vuajtjes, ish burgjet dhe kampet e internimit, iu nënshtruan shkatërrimit të vazhdueshëm, ndërrimit të destinacionit, ose asgjësimit të plotë, duke humbur kështu, edhe një pjesë të madhe të gjurmëve fizike të komunizmit, duke e bërë gjithnjë e më të padokumentueshëm dhe të pabesueshëm gjithë atë histori 47 vjeçare. I gjithë ky proces amnezie, keq-menaxhimi, i shoqëruar edhe me një mungesë të theksuar dokumentacioni, provash zyrtare të krimeve të komunizmit, e vështirëson jashtë mase riprodhimin e periudhës komuniste.

Në këto kushte, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, me projektin e këtij muzue virtual të komunizmit, tërheq vëmëndjen publike drejt dramës së asaj kohe dhe rrit ndërgjegjësimin publik dhe politik mbi trashëgiminë komuniste. Dhe nga ana tjetër, përmes filmimeve, ai përjetëson, arkivon vizalisht këto vende, dhe bashkë me ta, edhe vetë historinë e të shkuarës komuniste.

Përmbajtja e Muzeut Virtual të Komunizmit:

Gjatë katër viteve që parashikohet të zgjasë ky projekt pilot, në varësi të buxhetit të aprovuar, do të realizohen një seri filmash mini-muze virtualë, duke përdorur si tematikë ish-vendet e vuajtjes (burg, kamp me tela, kamp pune, ose vend ekzekutimi). Deri tani, në bazë të studimi të botuar nga ISKK bazuar mbi dokumentacionin zyrtar, lista është e tillë:

a. Kampet e internimit me tela:

Kampi i Krujës, mars 1945 – shtator 1947
Kampi i Beratit, mars 1945 – maj 1949
Kampi nr.4 (më pas 6) Tepelenë, 1949 – 1953
Porto – Palermo (maj 1949 - dhjetor 1950)
Lozhan, prill – dhjetor 1949 (Maliq)
Kampi i fermës “29 nëntori” Lushnjë (1950)
Kampi i fermës “Çlirimi” Fier (1950)
Kampi nr.3 (në fund nr.5), Valias, Cërrik dhe Kamëz, 1948 – 1953

a. Burgjet:

Burgu nr.1 Peshkopi, vitet 1944 – 1950
Burgu nr.3 Burrel (ose reparti nr.321), vitet 1946 – 1991
Burgu nr.4 Shkodër (më vonë reparti 315), vitet 1944 – 1966
Burgjet nr.2 dhe nr.5 Tiranë ose Reparti nr.313, vitet 1944 – 1991
Burgu nr.7 Durrës, vitet 1945 – 1953
Burgu nr.9 Berat, vitet 1944 – 1953
Burgu nr.11 Vlorë (reparti nr.319 Vlorë), vitet 1944 – 1964
Burgu nr.13 Elbasan, vitet 1944 – 1953
Burgu nr.15 Korçë vitet 1944 – 1964
Burgu nr.17 Gjirokastrër, vitet 1944 – 1953
Burgu nr.18 Kukës, vitet 1945 – 1949
Burgu nr.20 Kavajë, vitet 1945 – 1948
Reparti nr.307 në Tepelenë, vitet 1970 – 1973

b. Kampet e punës të të burgosurve 1947 – 1990

Prill – tetor 1946, Juba, kampi i parë i punës
Stadiumi “Qemal Stafa”
Kampi i Maliqit (Korçë)
Bedeni (Kavajë)
Kampi i Lekajt në Kavajë, 1949
Vlashuk (Berat) 1948 – 1949
Kamëz (Tiranë)
Kanali “Naum Panxhi”
Kampet ku mbaheshin “monarko – fashistët” grekë, 1948 – 1958
Kampet e hekurudhës Peqin – Elbasan, (janar – shtator 1950)
Kampi i Yzberishtit

	<p>Kampi i ullishtave të Vlorës Kampi nr.6, Rrapi i Trishit Tiranë dhe Varibop (1952 – 1953) Kampi nr.7 Tiranë (viti 1953) Gjendja e kampeve të punës dhe internimit Riorganizimi i fermave shtetërore dhe puna e detyruar Kampburgu Punëtorja Qendrore e Artizanatit 1950 – 1967 Reperti nr.301, ish kampi nr.1, nga Maliqi në Bulqizë Reperti nr.302 Reperti nr. 303, ish kampi nr.2, nga Peqini në Spaç Reperti nr.305, rruga nga Sukthi në Sarandë (1950 - 1991) Reperti 307 në Valas, vitet 1973 – 1983 Reperti nr.311 (Sarandë), vitet 1958 – 1959 Reperti nr.311 Qafë – Bari Reperti i Riedukimit nr.312, vitet 1987 – 1991 Reperti i Riedukimit nr.314 i Bardhorit Kavajë Reperti nr.315, nga Gradishta në Lezhë, në vitet 1966 – 1983 Reperti nr.316, Fushë Arrëz, viti 1974 Reperti nr.318 (Kuçovë 1966 – 1976), (Kosovë 1976 – 1991) Reperti i Riedukimit nr.323, Fushë – Krujë (1963 – 1967) Reperti i Riedukimit nr.325 Reperti nr.327 Gjirokastër 1989 – 1991 Reperti nr.328 Bençë 1989 – 1991 Reperti i Riedukimit nr.387 Tropojë Shtëpia e Pushimit Durrës Kompleksi “Dinamo” Tiranë</p> <p>Qëllimi i projektit:</p> <p>Informimi dhe edukimi i publikut mbi krimet, padrejtësitë dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, gjatë periudhës komuniste (1944-1991).</p> <p>Në një kornizë më të gjërë, përmes këtij projekti, synohet të krijohet një ide e qartë mbi natyrën anti-humane të këtij regjimi dhe regjimeve totalitare në përgjithësi.</p> <p>Objektivat e projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të informojë publikun mbi burgjet dhe kampet në Shqipërinë Komuniste dhe kushtet mizore të trajtimit të viktimave - Të evidentojë dhe të ruajë dhe trashëgiminë materiale komuniste, si dëshmi e një epoke historike - Të edukojë brezat a rinj me ndjeshmëri dhe përgjegjësi historike ndaj të shkuarës dhe të sotmes
--	--

- Të nderojë vuajtjet e njerëzve të pafajshëm, viktima të një sistemi totalitar
- Të ndërkombëtarizojë historinë e komunizmit në Shqipëri.

Vështirësitë e projektit:

Sipas një studimi të gjendjes, vetëm një pjesë e vogël e këtyre vendeve, ekzistojnë fizikisht, qoftë edhe si gjurmë ose rrënoja. Si rezultat, vetëm një pjesë e tyre krijojnë mundësi për filmim, si fjala vjen: ish kampi i internimit me tela në Tepelenë, ish burgu i Spaçit, ish kampi i Thumanës, ish kampi i Uzinës së Superfosfatit, ish kampi i Ballshit, shesh ekzekutimi në Shpal të Mirditës, etj.

Sfida tjetër me të cilin duhet të përballemi gjatë këtij projekti është fakti që edhe këto site ekzistuese, janë aq të dëmtuara ose të transformuara në kohë, saqë kanë humbur pothuajse çdo shenjë autenticiteti. Kështuqë në këtë rast, dëshmitë, dokumentet, janë një element mëse i domosdoshëm dhe vendimtar për t'i rindërtuar virtualisht. Ndaj filmimit dhe përgatitjes virtuale i paraprin një fazë kërkimore dokumentacioni, dhe këshillimi me disa nga të mbijetuarit, të cilët ofrojnë eksperizën e duhur.

Një tjetër vështirësi në këtë projekt është edhe meanaxhimi i këtij projekti në kohë, pasi një pjesë e vendeve të lartpërmendura, edhe nëse ekzistojnë si gjurmë, rrezikojnë të zhduken se përgjithësisht janë lënë në mëshirë të komuniteteve pëkatëse, të cilët kanë fare pak njohuri ose pothuajse aspak, mbi domethënien dhe historinë e tyre vendeve.

Përparësitë e projektit:

- Akses i shpejtë në publik si formë elektronike
- Mundësitë e mëdha të teknologjisë dixhitale në hartën e shpërndarjes, lëvizshmërisë dhe personalizimit.
- Impakti i fuqishëm vizual dhe akustik i informacionit në shqisat e audiencës
- Krijimi i retrospektivës historike përmes mjeteve dixhitale, në mungesë të trashëgimisë reale dhe dokumentuese

Audienca e projektit:

- Publiku shqiptar i të gjitha moshave
- Institucionet arsimore
- Audiencat e huaja, të cilat kanë kaluar përmes një përvojë të ngjashme në vendet e tyre
- Qendrat studimore

	<ul style="list-style-type: none"> - Media shqiptare dhe e huaj të cilët shfaqin interes për historinë komuniste në Shqipëri.
<p>REZULTATET E VITIT 2018</p>	<p>Realizimi i muzeut virtual “Kampi i internimit në Tepelenë”</p> <p>Gjatë vitit 2018, sipas parashikimit, ISKK arriti të realizojë filmin e parë dokumentar mbi kampin e Tepelenës, i konceptuar në formën e një muzeu digjital me xhirimet aktuale të gjendjes së kampit në cilësinë 4K dhe me ndihmën e grafikës 3D. Filmi zgjat 10 minuta. Pas promovimit të filmit në konferencën e planifikuar të zhvillohet me 25 shkurt 2019, produkti shkarkohet në Youtube, ku bëhet i aksesueshëm për publikun e gjërë. Ndërkohë materiali u shpërndahet për përdorim organizatave partnere dhe institucioneve që i shërbejnë transparencës së epokës komuniste në shqipëri, si edhe muzeve historikë.</p> <p>Përshkrimi i projektit:</p> <p>“Muzeu virtual i Kampit të Tepelenës”, është pjesa e parë e “Muzeut Virtual të Komunizmit”, një projekt afatgjatë i ndërmarrë nga ISKK për katër vite.</p> <p>Me këtë muze virtual synohet të rindërtohet historia pesëvjeçarë e ish-kampit të internimit me tela të Tepelenës, i cili ka funksionuar si i tillë gjatë periudhës 1949-1954. Sipas dëshmive, për shkak të trajtimit të keq, ushqimit të keq dhe epidemive, në këtë kamp vdiqën shumë të internuar, deri në dhjetë vetë brenda natës, kryesisht fëmijë dhe pleq. Elementë të tjerë për t’u evidentuar brenda këtij projekti, janë edhe trajtimi i dhunshëm nga komanda si edhe puna e rëndë, të cilës i nënshtroheshin të internuarit. Numri i të internuarve në këtë kamp, varion nga 3000-5000. Në mungesë të dokumentacionit mbi këtë kamp, rrëfimi do të bazohet kryesisht mbi dëshmitë e të mbijetuarve.</p> <p>Qëllimi i këtij projekti është që në mungesë të dëshmive fizike, në mungesë të një kampi-muze të Tepelenës, publiku të mund të eksplorojë virtualisht këtë ngjarje, duke krijuar një ide dhe një ndjeshmëri mbi të.</p> <p>Realizimi i projektit kaloi nëpër disa faza:</p> <p>a. Faza përgatitore: (Nëntor 2017- qershor 2018)</p>

Gjatë kësaj faze, dy punonjës të ngarkuar nga Instituti, kryen punën kërkimore për të mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm mbi këtë ngjarje, duke filluar nga dokumentet arkivore në institucionet përkatëse, e deri tek dëshmitë e vuajtësve të mbijetuar nga ky kamp. Gjatë kësaj kohe, duke u konsultuar edhe me konsulentë, u hartua skenari i ngjarjes mbi të cilin konceptohet filmi, u përcaktuan parametrat dhe kostoja e projektit. Pastaj u kalua në procesin e tenderimit të ekipit të produksionit që do të merrte përsipër produksionit.

b. Produksioni

(Qershor 2018-shtator 2018)

Pas përzgjedhjes me tender të ekipit të produksionit, u nënshkruan kontratat e bashkëpunimit, dhe u hartua plani i veprimtimit. Ekipi i kontraktuar në bashkëpunim me grupin e punës të ISKK, ndoqën këtë plan pune:

- Lexuan, bënë hulumtimet, ekspertizën dhe përfunduan skicë-idenë e projektit.
- Planifikuan dhe koordinuan të gjitha aspektet e prodhimit të filmit
- Krijuan ekipin e xhirimit, duke përfshirë një drejtor dhe një ekip për të xhiruar filmin
- Detajuan buxhetin
- Organizuan kalendarin dhe vendin e filmimeve
- Mbikëqyrën gjithë ecurinë e projektit nga prodhimi në post-produksion.

Gjatë kësaj faze, një ekip produksioni shkoi edhe filmoi mbetjet materiale të kampit të Tepelenës, një aktivitet që zgjat pesë ditë. Grupi i xhirimit u shoqërua nga skenaristi dhe konsulentët, në mënyrë që të filmoheshin pamjet e duhura. Meqenëse gjurmët fizike të këtij kampi janë zhdukur pjesërisht, projekti u bazua mbi filmimin e mureve të kazermave të cilat janë akoma ekzistuese, filmimin e objekteve personale të cilat kanë vlerën e dëshmisë. Një gjeometër për tre ditë me radhë, bëri gjithë matjet e duhura të domosdoshme për arkitekturën grafike.

Pas filmimit të pamjeve reale, materialet e filmuara kaluan në dorë të arkitektit grafik, i cili e rindërtoi kampin duke përdorur këto programe: 3d reconstruction, 3d tracking, 3d modeling. Gjatë gjithë procesit të kompozimit grafik, arkitekti është konsultuar me dy të mbijetuar të këtij kampi, për detajet më të hollësishme, për materialet e përdorura dhe funksionin.

c. Post-produksioni

(Gusht 2018-tetor 2018)

Gjatë kësaj fazë, i gjithë materiali i filmuar dhe ai grafik, iu nënshtrua përpunimit dhe montazhit filmik, në varësi të skenarit. Pjesë e post-produksionit është edhe përkthimi i tekstit, voiceover-i dhe efektet zanore.

d. Publikimi i muzut virtual

(Tetor 2018-Nëntor 2018)

Pas post-produksionit, dhe pas promovimit të filmit me datë 25 shkurt 2019, videoja e përgatitur publikohet në faqen zyrtare të ISKK, në youtube, u nisët institucioneve partnere, dhe shpërndahet në rrjetet sociale.

Një formë tjetër e publikimit të kësaj videoje, është edhe shfaqja e materialit për nxënësit nëpër shkolla, si pjesë e marrëveshjes së ISKK me Ministrinë e Arsimit, për informimin e të rinjve për historinë e komunizmit në Shqipëri.

Pritshmëritë e projektit

- Shikueshmëri nga një audiencë prej 2 milionësh, brenda dhe jashtë vendit
- Mbledhja e provave dhe dokumentave materiale, të cilat bëhen pjesë e arkivës së ISKK
- Konferenca dhe debate publike të provokuara nga ky projekt.

Grupi i Punës

Luljeta Lleshanaku (skenariste); Agron Tufa (drejtues i projektit); Elton Baxhaku (kineast, bashku me ekipin e produksionit); Klit Burda (arkitekt grafik); Aziz Ndreu (i mbijetuar i Kampit të Tepelenës, konsulent); Dine Dine (i mbijetuar i Kampit të Tepelenës, konsulent).

Partnerë të projektit

Fondacioni Konrad Adenauer në Tiranë

Puna kërkimore përgatitore për realizimin e dy muzeve të tjerë virtualë:

- **Kampi të Punës së Maliqit**
- **Burgut të Ballshit**

1. Muzeu virtual i Kampi të Punës së Maliqit

Kampi i Punës në Maliq, që ishte një kantier pune për tharjen e kënetës, konsiderohet si një nga momentet më të tmerrshëm përsa i përket trajtimit të të burgosurve politikë, dhe si i tillë mjaft i rëndësishëm për të qenë pjesë e këtij projekti.

Nga muaji nëntor 2018, një grup pune nga ISKK i ngarkuar me projektin filmik, ka filluar punën kërkimore në arkivat shtetërore, në arkivën e video-regjistrimeve të dëshmimeve në Institut, dhe në kontaktimin e të mbijetuarve shumë të paktë të Kampit të Punës së Maliqit, si bazë të dhënash të domosdoshme për skenarin e dokumentarit që i kushtohet këtij kampi. Po bëhen kërkime për gjetjen e projektit të tharjes së Maliqit, për të përcaktuar planimetrinë, të dhënat fizike dhe proceset e punës. Ndërsa përsa i përket mënyrës se si ishte ndërtuar kampi, si funksiononte, e aq më tepër mbi mënyrën e trajtimit të të burgosurve, do të bëhet një tjetër kërkim, kryesisht në dëshmitë e të mbijetuarve të këtij kampi.

Ky projekt konsiderohet mjaft i vështirë, për shkak të mungesës së dëshmitarëve dhe mungesës së evidencave fizike të kampit, pasi lokacioni është transformuar i gjithi pas tharjes së kënetës. Për këto arsye, puna kërkimore për këtë projekt parashikohet të zgjasë më shumë se një vit.

2. Muzeu virtual i Burgut të Ballshit

Burgu u Ballshit është shumë më i vonë se Kampi i Punës në Maliq, por ka hyrë në kujtesë si një burg ku mbaheshin kryesisht të moshuar, deri edhe në moshën 90 vjeç, persona të paaftë për punë, në kushtet e urisë dhe të denigrimit fizik dhe psikologjik.

Ish Burgu i Ballshit për fat ekziston fizikisht, megjithëse i rrënuar, çka e bën më të lehtë rindërtimin e kampit përmes arkitekturës grafike. Ndërkohë kanë filluar kërkimet për dokumentacion mbështetës dhe dëshmitë e të mbijetuarve të këtij kampi, për hartimin e narrativës së filmit. Muzeu virtual i Ish Burgut të Ballshit, pritet të përfundojë gjatë

	<p>vitit 2019.</p> <p>Grupi i Punës: Luljeta Lleshanaku, Agron Tufa, 3 konsulentë.</p>
--	---

1.4.2 “PARA dhe PAS”- Ekspozitë fotografike online

TITULLI I PROJEKTIT	“PARA dhe PAS”- Ekspozitë fotografike online
LLOJI I PROJEKTIT	Projekt afatgjatë
KOHËZGJATA E PROJEKTIT	5 shtator 2018- 5 shtator 2023
PËRMBAJTJA	<p>Përshkrimi i projektit</p> <p>Nga të paktat dëshmi që vuajtësit kanë mundur të ruajnë nga e shkuara, janë fotot familjare, por edhe këto në masë të kufizuar, për shkak të sekuestrimeve, eliminimit nga frika e shpërdorimit gjatë kontrolleve nga punonjësit të Sigurimit të Shtetit, dhe humbjeve nga zhvendosjet e herpashershme në kampe internimi ose dëbimet.</p> <p>Bazuar mbi forcën dhe impaktin e drejtëpërdejtë e të pastër të imazhit tek audiencat, përdorimi i këtyre fotove në një ekspozitë online, do të ndihmonte mjaft veçanërisht brezat e rinj për të kuptuar atë ndrushim të madh negativ që solli diktatura koministe në jetën e individit, në planin e mirqënies sociale, të drejtave të njeriut dhe botëkuptimit kolektiv.</p> <p>Ky projekt konsiston në një ekspozitë online fotografish në faqen zyrtare elektronike të ISKK, të titulluar “PARA dhe PAS”. Në këtë ekspozitë do të shfaqen foto individuale dhe familjare, para dhe pas instalimit të dikaturës, ose para dhe pas përvojës së persekutimit. Ndjekja e fatit të individëve dhe familjeve të persektuara nga regjimi komunist përmes fotove, e bën të pashmangshëm dallimin e madh midis dy kohëve.</p> <p>Por pjesë e kësaj ekspozite nuk janë vetëm viktimat e komunizmit, por edhe qytetarë të zakonshëm nga gjithë Shqipëria, nga të gjitha shtresat sociale, për të kuptuar transformimin e krejt shoqërisë shqiptare gjatë këtij regjimi.</p>

E fundit por jo më pak e rëndësishme është edhe qasja e dy epokave, para dhe pas hyrjes së komunizmit, përmes transformit të vendeve, objekteve, stilit të jetesës. Të gjitha këto, do të jenë pjesë e një ekspozite që përditësohet dhe zgjerohet vazhdimisht me prurje të reja, si një muze ku gjithkush e gjen veten në një farë mase.

Qëllimi i projektit:

Qëllimi i këtij projekti është informimi dhe sensibilizimi përmes fotografive i brezit të ri mbi natyrën e shtetit komunist.

Objektivat e projektit:

- Evidentimi i transformimit ekonomiko-social të vendit në diktaturë
- Evidentimi i rasteve të përndjekjes (pushkatim, burgosje, internim) për arsye politike
- Evidentimi i stilit të jetesës në komunizëm
- Ndërgjegjësimi i vetë të përndjekurve politikë mbi rëndësinë e dëshmisë vizuale
- Lehtësimi i aksesit të gjërë publik përmes ekspozimit online

Realizimi i projektit:

Një grup punë prej tre vetësh, prej muajit tetor 2018, ka nisur punën për mbledhjen e fotografive dhe konceptimin grafik të ekspozitës. Deri tani, ky grup punë ka kontaktuar rreth tridhjetë individë dhe famije, të cilat janë të gatshme të ofrojnë fotot e tyre private për këtë projekt.

Fotot do të shoqërohen me një shënim shpjegues, ku të jepen të dhëna se kujt i përkasin fotot (emrin, mbiemrin, vitin e lindjes), kohën dhe vendin ku janë bërë fotot, dhe ndonjë histori të shkurtër mbi historinë e individit (ose familjes) së ekspozuar.

Procesi i mbledhjes së një numri të konsiderueshëm fotosh dhe konceptimit grafik zgjat deri në muajin shtator 2019, kur ISKK parashikon të hapë këtë ekspozitë. Ndërkohë, kjo arkivë do të zgjerohet, të përditësohet vazhdimisht, duke u parë si një mundësi për projekt afatgjatë, që mund të zgjasë për pesë vite.

Grupi i punës:

Daniela Runa, Daniel Miraka, Pëllumb Alushi.

1.4.3 “Komunizmi në Shqipëri”- Seri video-montazhesh në dy gjuhë

TITULLI I PROJEKTIT	“Komunizmi në Shqipëri” Seri video-montazhesh në dy gjuhë
LLOJI I PROJEKTIT	Projekt afatgjatë
KOHËZGJATA E PROJEKTIT	2016-2023
PËRMBAJTJA	<p>Bacground-i projektit:</p> <p>Në vitin 2016, me kërkesë të grupit kurator të Muzeut “Shtëpia e gjetheve”, ISKK përgatiti një video-montazh me pjesë nga më domethënëset lidhur me terrorin në hetuesi.</p> <p>Në vitin 2017, për të bërë më interesante dhe më të prekshme ciklin e bisedave nëpër shkolla, ISKK përgatiti edhe dy video-montazhe të tjera, si një mjet didaktik.</p> <p>Në të dyja rastet, për krijimin e këtyre montazheve filmike, ISKK i është referuar arkivës së video-regjistrimeve të krijuar tashmë prej 7 vitesh.</p> <p>Zgjerimi dhe prezantimi i aktivitetit të ISKK në konferenca ndërkombëtare dhe interesi i studjueve të huaj për historinë e komunizmit në Shqipëri, shtron nevojën e përgatitjes së disa drafteve filmike dëshmish, si edhe të përkthimit në anglisht.</p> <p>Përshkrimi i projektit</p> <p>“Komunizmi në Shqipëri” është një projekt afatgjatë i cili synon të krijojë aspekte të ndryshme të persekutimit komunist në Shqipëri përmes rrëfimeve të filmuara të të mbijetuarve, si: kampet me tela, kampet e punës, burgjet, trajtimi në hetuesi, internimet, puna e rëndë, dëbimet, përçarja sociale, propaganda komuniste, etj.</p> <p>Qëllimi i projektit:</p> <p>Qëllimi i këtij projekti është informimi dhe sensibilizimi i publikut dhe qarqeve akademike vendase dhe të huaja, përmes dëshmimeve filmike të të mbijetuarve të krimeve të komunizmit.</p> <p>Objektivat e projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimi publik mbi krimet e komunizmit në Shqipëri


	<ul style="list-style-type: none"> - Informimi i studjueve të huaj mbi natyrën e komunizmit në Shqipëri dhe përmes tyre ndërkombëtarizimin e kësaj historie - Forcimi i impaktit tek të rinjtë përmes mënyrave më interaktive të prezantimit të kësaj epoke - Zgjerimi i partneritetit me organizata ndërkombëtare që I shërbejnë memories komuniste - Zgjerimi i rrethit të donatorëve dhe lobuesve të kësaj çështjeje brenda dhe jashtë vendit
<p>AKTIVITETET PËR VITIN 2018</p>	<p>“Historia e komunizmit në shqipëri”- video-montazh ne anglisht dhe shqip</p> <p>Për përgatitjen e këtij video-montazhi u shqyrtuan përrreth 30 dëshmi audio-vizuale, në rreth 90 orë filmime. Meqenëse qëllimi ishte të ndërtohej një sinopsis i shkurtër gjithpërfshirës, në dy gjuhë, i persekutimit komunist në Shqipëri, u përzgjedhën rrëfimet e këtyre personave: Skënder Stefanllari- rrëfimi mbi Kampin e Maliqit; Lavdosh Beqo-rrëfimi mbi Kampin e Maliqit, Burgun e Burrelit, Kampin e Gosës dhe Bedenit; Azis Ndreu- rrëfimi mbi kampin e Tepelenës; Kurt Kolar-rrëfimi mbi Kampin e Tepelenës dhe të Porto Palermos; Qamil Merlika-rrëfimi mbi kampin e Beratit dhe të Kuçovës; Simon Miraka-rrëfimi mbi kampin e Tepelenës.</p> <p>Të gjitha rrëfimet janë ndërthurur me njëri-tjetrin, në një mënyrë që të krijojnë një narrativë interesante dhe të plotë. Pas montazhit, materiali kaloi për përkthim në anglisht, dhe pastaj për venien e titrave.</p> <p>Grupi i punës: Luljeta Lleshanaku, Agron Tufa, Pëllumb Alushi.</p>

2. BOTIMET

2.1 BOTIMET STUDIMORE/DOKUMENTUESE

“Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist”, Vëllimi VII (Gërmat ‘Q’, ‘R’, ‘Rr’, ‘S’)

Çelo HOXHA (redaktor), Kolë KAMSI (redaktor), Brunilda DOÇI, Juliana KURTI, Daniela RUNA, Ona ILIAZI, Zoica GRAÇI



Gjatë vitit 2018, Drejtoria e Arkivës realizoi vëllimin 7 të *Fjalor Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist*, shkronjat Q, R, Rr, S, i cili u botua në tetor dhe ka grumbulluar dokumente arkivore në lidhje me objektin e studimeve të ISKKK.

Për këtë numër u konsultuan dhe radhitën (zbardhën) rreth 5000 dokumente: deklarata personale, vendime gjyqi, vendime të Komisionit tre palësh; këto dokumente janë grumbulluar nga punonjësit e arkivës dhe gjenden në arkivën elektronike të ISKK. Veç këtyre janë shfrytëzuar dhe materiale të botuara si gazeta, libra, etj., të cilat janë dhënë me referenca të sakta në vëllimin e botuar. Puna u zhvillua në dy faza: një, përzgjedhja e dokumenteve përkatëse për vëllimin nga grupi i përgjithshëm i dokumenteve, rreth 62 mijë dokumente elektronike (dokumente

originale të fotografuara; dy, dokumentet e përzgjedhura (rreth 5000) u radhitën. Proces tjetër ishte redaktimi i materialit që u bë nga dy redaktorët përgjegjës për përgatitjen e enciklopedisë.

“Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri (vëllimi V): Komiteti Ushtarak i Delvinës”

Leka NDOJA



Gjatë vitit 2018, studjuesi Leka Ndoja, përgatiti studimin me dokumente: “Komiteti Ushtarak i Delvinës”, vëllimi 5 i serisë “Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri”, 340 f. E gjithë seria ka arritur deri tani në 2 000 faqe botim dokumentesh të pajisura: me parathënie, me shënime, hyrje për çdo kapitull dhe përfundime. Libri gjithashtu është i pajisur me aparat shpjegues termash dhe bibliografik.

Hartimi i studimit “Komiteti Ushtarak i Delvinës”, është bazuar kryesisht në burimet arkivore: të Ministrisë së Brendëshme (AMPB), të Ministrisë së Mbrojtjes (AQFA), të AQSH dhe të arkivave private të familjes së Riza Resulit dhe të Alush Sejkos dhe bashkëpunimit të tyre prej më se një viti, për pasqyrimin e detajuar të kontekstit të persekutimit gjatë viteve 1947-1948 të të ashtuquajturit “Komiteti Ushtarak Klandestin” të Regjimentit 7 të Delvinës. Libri është i ndarë në tre kapituj; Kapitulli i parë: “Procesi Hetimor”, Kapitulli i dytë: “Procesi i Gjykimit”, Kapitulli i tretë: “Përpunime të Sigurimit dhe Rihapja e Çështjes”, Apendiksi.


Gjatë proceseve zhvilluar nga 27 nëntori deri më 5 dhjetor 1947, në Gjykatën Ushtarake të Gjirokastrës, në gjyqet kundër “Komitetit të Delvinës” u dhanë 15 dënime me vdekje, ndërsa Gjykata e Lartë Ushtarake, la në fuqi 9 prej tyre. Dr. Riza Resuli, Alush Sejko, Myrto Hyso dhe Dr. Paulin Shestani, u ekzekutuan më 13 janar 1948; Koço Manari dhe Shaban Ndreu vdiqën nga torturat në hetuesi.

Ky proces i montuar politik, nga Sigurimi i Ushtrisë në qendër dhe në Regjiment (Shef Sig. i Regj. 7, Nesti Nase) drejtuar nga Koçi Xoxe nën udhëzimet Enver Hoxhës kishte si qëllim të terrorizonte radhët e ushtrisë në jugun e vendit, duke dënuar ushtarakët nacionalistë apo që kishin ardhur me misionin amerikan nga Bari, si Alush Sejko. Gjithashtu, dënimi i dy mjekëve Resuli dhe Shestani, nëpërmjet deklarimeve false, kishte si qëllim implikimin e tyre nga Sigurimi në ngarkim të Grupit të dytë të Deputetëve, proces i cili përfundoi më 22 janar 1948.

Me këtë libër me dokumente krijohet një panoramë e përgjithshme e krijimit të “organizatave” false si “Komiteti Ushtarak i Delvinës”, si pjesë e praktikës së Sigurimit, duke përfshirë në të mjekët të shquar, komunitetin çam, atë të Delvinës dhe ushtarë të thjeshtë. Në këtë proces u arrestuan rreth 100 ushtarakë dhe civilë, me akuza të rreme, të argumentuara nga dëshmitë e disa prej protagonistëve të përmbledhura në këtë vëllim.

“Krimet e komunizmit: një histori e plotë për në mirditën (1944-1950)”

Tanush KASO



Jo rastësisht qarku i Mirditës rikthehet herë pas here në vëmendje, sa herë që flitet për krimet e Komunizmit. Të internuarit në Kampit të Tepelenës kujtojnë ata qindra mirditorë që i sollën brenda një nate të vetme në kamp, pas vrasjes së Bardhok Bibës. Por burimi i hakmarrjes së pushtetit të asaj kohe ndaj kësaj zone, fillon shumë më herët, tek rezistenca e armatosur e krerëve të Veriut ndaj instalimit të komunizmit në vitin 1944, nën drejtimin e Familjes GjonMarkaj. Pak më vonë, ishte populli i Mirditës ai që strehoi dhe u sakrifikua për grupet e diversantëve që hynin ilegalisht në Shqipëri, me qëllim organizimin e një kryengritje të armatosur kombëtare antikomuniste. Por vrasja e Bardhok Bibës, që shërbeu si pretekst i masakrës së njohur si masakra e Mirditës të drejuar nga Mehmet Shehu, përbën edhe kulmin e kësaj armiqësie me një zonë të tërë, ngjarje në të cilën u arrestuan dhjetëra dhe u dënuan 26 mirditorë; u varën në litar katër mirditorë të

pafajshëm dhe u pushkatuan 10 të tjerë. Ky studim fokusohet pikërisht në background-in dhe argumentimin e këtij akti barbar dhe sidomos në misterin e vrasjes së Bardhok Bibës, në emër të së cilës, u bë genocidi.

Për të ndërtuar historikun e këtyre ngjarjeve, për një qasje dhe gjykim sa më objektiv, autori Tanush Kaso i referohet kryesisht burimeve të ndryshme, duke filluar nga dokumentacioni zyrtar i shtetit shqiptar, arkiva e Sigurimit të Shtetit, raportet partiake, arkivave të organizatave politike në emigrim, dëshmime okulare, dëshmime të misionarëve anglezë të atashuar në Shqipëri, etj.

“Histori të retushuara të komunizmit” - (Album narrativ)

Kastriot DERVISHI




Albumi “Histori të retushuara” i Kastriot Dervishit hedh dritë mbi një aspekt shumë specifik të propagandës komuniste: mbi censurën e imazhit. Sipas studjuesit “censura historike paraqitet në dy forma: në ndalesën e përgjithshme të shfaqjes së figurave historike (Mbreti Zog nuk njihej fare nga populli si portet), si dhe në botimin e fotove të retushuara, të cilat ndryshonin herë pas here. Në atë kohë nuk kishte programe të posaçme kompjuterike siç ka në ditët tona, por përdorej teknika e thjeshtë e prerjes me gërshtë, montimit dhe rifotografimit. Duhet patjetër që udhëheqësi të ishte me ‘burra të mirë’ të çastit, e jo me persona që Partia i kishte shpallur ‘tradhtarë’, apo nuk i dëshironte. Duke qenë një metodë thellësisht artizanale, shpeshherë harrohej spastrimi tërësor e fotografisë,

tek-tuk mund të ngeleshin këmbë, duar, etj.”

Ky album sjell foto të marrra nga arkivat, në gjendjen e tyre para retushimit dhe pas retushimit, dhe të shoqëruara me shpjegime. Ndonëse manipulimi i historisë përmes imazhit është një fenomen i njohur në të gjithë regjimet totalitare, evidentimi përmes dokumentave do të ishte me mjaft interes vecanërisht për brezat e rinj, për të kuptuar mekanizmin dhe impaktin e propagandës, në një vend të izoluar si ky i yni.

“Martiri Dom Shtjefen Kurti”- monografi

Nikolin KURTI, Nikollë LOKA



Monografia e Dom Shtjefën Kurtit është i pari botim në këtë gjini mbi këtë figurë, që më së shumti simbolizon persekutimin e klerit katolik në Shqipëri nga regjimi komunist. Siç shfaqet edhe në biografinë e tij në këtë libër, Dom Shtjefën Kurti ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për bashkimin e shqiptarëve dhe në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve; me mbështetjen e Mbretit Zog, hartoi përkujtesën “Gjendja e pakicës shqiptare në Jugosllavi”, e cila iu dërgua Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

I arsimuar në Itali dhe Austri, me një reputacion të jashtëzakonshëm në popull si klerik dhe atdhetar, viti 1945 e gjeti Dom Shtjefën Kurtin famulltar në kishën e famullisë katolike në Tiranë. Por këtu fillon edhe përndjekja e tij që nuk ndalet asnjë çast deri në vdekjen e tij. Më konkretisht, ai u arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me 20 vjet burg si agjent

i perëndimit. Lirohet nga Burgu i Burrelit në vitin 1966, dhe arrestohet sërish në vitin 1971, për spunazh, sabotazh, dhe kryerjen në fshehtësi të riteve fetare. Madje hitstoria e tij e ekzekutimit vetëm për shkak se pagëzoi një fëmijë, ka mbetur në kujtesën kolektive si një nga përvojat më absurde dhe më të shëmtuara të komunistëve. U pushkatua, por sot e kësaj dite nuk gjenden eshtrat e tij. Me 5 Nëntor 2016, Dom Shtjefën Kurti qe një nga 40 klerikët që u lumnua si “Martir” dhe u pranua shenjtor i Kishës Katolike.

Për hartimin e kësaj monografie, autorët i janë referuar dokumentacionit të AQSH, Ministrisë së Brendshme, arkivës së Vatikanit, si edhe studimeve të shumta dhe artikujve shkencorë të realizuar deri tani mbi Klerin Katolik, që në këtë rast shërbejnë si burime të ndërmjetme referimi.

“Provinca e egër; SOE në vendin e shqipeve” nga Roderick Bailey

Përktheu dhe përgatiti për botim Alvin SARAÇI

Libri i përkthyer nga anglishtja dhe në proces botimi Roderick Bailey, “The Wildest Province SOE in the Land of the Eagle”, London Vintage books, 2008, i përket fushës së historisë bashkohore dhe trajton historinë e misionit britanik në Shqipëri në periudhën e Luftës së II Botërore. Ai ka rëndësi për marrëdhëniet shqiptaro-britanike dhe bazohet mbi një sërë burimesh arkivore dhe dëshmish të protagonistëve, ku autori hedh dritë mbi rolin e rëndësishëm të oficerëve britanikë të ndërlikues në raportet me partizanët e drejtuar nga komunistët, Legalistët dhe Ballin Kombëtar. Në libër, reflektohet politika britanike lidhur me Shqipërinë e Kryeministrit Winston Churchill, Parlamentit Anglez, Foreign Office dhe War Office, Komandës së Përgjithshme të Mesdheut, Komitetit të Operacioneve Speciale dhe rolit të Special Operations Executive (SOE) me seli në Londër dhe në Bari, në kuadër të nxitjes të të gjitha forcave që përkrahnin rezistencën antifashiste dhe çlirimin e vendit nga italianët dhe gjermanët. Gjithashtu, libri fokusohet mbi arritjet e britanikëve në Shqipëri: përvojën e çmuar ushtarake që ata dhanë për ngritjen e njësisë të para partizane që do të përballëshin me forcat italiane dhe gjermane dhe tërheqjen në një front të përbashkët të tyre me forcat legaliste dhe ballisto-nacionaliste si dhe zbutjes së fërkimeve ndërmjet tyre, furnizimit me anë të aeroplanëve britanikë me veshje, ushqime dhe municione dhe mbështetjes me anën e tij të veprimeve luftarake në terren, çarmatosjes së forcave italiane pas kapitullimit të Italisë Fashiste, bllokimit të rrugëve të komunikimit dhe të minierave e deri në pjesëmarrjen e njësisë të armatosura britanike përgjatë bregdetit shqiptar në operacionet kundër gjermanëve.

2.2 BOTIME MEMUARISTIKE

"Zërat e kujtesës", vëllimi V

Luljeta LLESHANAKU, Agron TUFA

Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunitetit



Ky është botimi i radhës i ISKK, në të cilin përmbledhen dëshmi të transkriptuara të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet e internimit në regjimin komunist. Rrëfimet janë të ndërtuara mbi bazën e intervistave, të cilat janë të arkivuara në formë audio-vizuale, dhe që zgjasin nga një orë deri në shtatë orë për secilin prej tyre. Dëshmuesit e përfshirë në këtë vëllim janë: Adriatik Agolli, Musa Çapani, Rudina Dema, Zenel Drangu, Tanush Kaso, Kurt Kola, Zef Lleshi. Përmes përvojave të tyre personale, të intervistuarit zbulojnë fakte, detaje, emra, në lidhje me burgun e Spaçit, Burgun e Burrelit, Burgun e Ballshit, Kampin e Punës së Superfosfatit në Laç, Kampin e internimit në Berat dhe Tepelenë, Kampin e Internimit na Katër Rrugët e Shijakut dhe në Kamzë, si edhe kampe të tjera pune më pak të njohura si ai i Fabrikës së Çimentos në Fushë Krujë, Fabrikës së Çimentos në Elbasan, Burgut të Bulqizës, Burgun e Zejmenit, etj.


Aspekte të tjera që zbulohen gjatë këtyre dëshmimeve janë edhe metodat e inskenimit të proceseve gjyqësore

dhe kthimi i të arratisurve nga Ish-Jugosllavia, mbi marrëveshje sekrete për të cilat nuk ka evidenca, ose që nuk janë zbuluar akoma.

Nga ana jetër, tre prej dëshmuesve kanë qenë në moshë të mitur kur janë internuar, dhe dëshmia e tyre ofron një bazë të rëndësishme informacioni për një nga shkeljet më flagrante të të drejtave të njeriut në shtetin komunist: dënimin e paligjshëm të të miturve.

“Një jetë me brenga” - kujtime

Kolec TOPALLI



“Arsyeja që më shtyu të hedh në letër këto kujtime është dëshira që brezi i rritur në demokraci të njohë sa e vështirë ka qenë jeta e intelektualëve dhe e gjithë popullit shqiptar në regjimin totalitar komunist.” - shpjegon prof. Kolec Topalli ne pasthënien e përmbledhjes së tij me kujtime të titulluar “Një jetë me brenga”. “Prandaj, në përputhje me këtë qëllim, në këto kujtime jam përqendruar vetëm në disa aspekte të jetës sime, që me fakte konkrete shtjellojnë ashpërsinë e luftës së klasave, e cila përbën absurditetin më të madh të atij regjimi, njëkohësisht edhe faqen më të dhimbshme të tij. Për këtë arsye kam lënë jashtë çdo gjë që lidhet me jetën personale e familjare, duke u përqendruar në marrëdhëniet e mia me pushtetin komunist dhe me botën shkencore, që ka qenë tej mase e politizuar.”

Ndryshe nga shumica e memuareve që fokusohen kryesisht në përvojat e familjeve ose ato individuale, prof. Topalli ofron një kornizë shumë më të gjërë: atë të transformimit social dhe fizik të shoqërisë që nga momenti i instalimit të shtetit komunist, e deri në ditët tona. Përdorimi i referencave, dëshmive përtej përvojës individuale, i jep rrëfimit të tij një vlerë që shkon përtej memuarit, drejt një studimi antropologjik. Libri është i pasur me fakte, është shkruar me një stil elegant publicistik, dhe me një saktësi të tillë shkencore që nuk i lë as edhe një mundësi autorit për koment apo për një qëndrim emocional ndaj ngjarjes.

Libri është konceptuar në disa kapituj: “Fëmijëria”, “Në internim”, “Vitet e rinisë”, “Në punë si mësues”, “Periudha e ushtrisë”, “Përsëri në arsim”, “Fillimet e punës shkencore”, “Në demokraci”, dhe “Në Institutin e Gjuhësisë”.

“Spaçi”- roman memuaristik

Shkëlqim ABAZI

Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunitetit



Shkëlqim Abazi

SPAÇI

memuaristikë

(Varri i të gjallëve)

Pas librit “Repsi”, një roman memuaristik që ISKK botoi vitin që shkoi, sheh dritën e botimit romani i dytë memuaristik i Shkëlqim Abazit, i titulluar “Spaçi”. Siç kuptohet edhe nga titulli, në fokus të këtij libri është burgu i tmerrshëm i Spaçit, i cili përshkruhet përmes përvojës personale të tij, si një ish-i burgosur politik që në moshën 16 vjeçare. Përmes një rrëfimi të detajuar, autori sjell situata dhe portrete bashkëvuajtësish, personazhe të njohur apo të panjohur, ngjarje nga realiteti jashtë kampeve që vijnë në një mënyrë të tërthortë përmes rrëfimeve, duke na dhënë jo vetëm një pamje më të plotë të burgut të Spaçit, por edhe një përshkrim të përgjithshëm të fizik dhe psikologjik të periudhës për të cilën bëhet fjalë, të botës brenda dhe jashtë burgjeve. Ajo që e bën veçanërisht interesant leximin e kësaj vepre është sensi i mprehtë ironik, grotesku, me të cilën e përcjell atë dramë absurde, si në këtë paragraf: “Vasil Dhimitriadhi, një grek me histori të trishtë që kaloi njëzet vjet në burgjet politike shqiptare, gjë që s’ka lidhje me temën, u desh të shtynte një muaj e gjysmë izolim pse kish lënë barsetat poshtë “kocit të partisë” edhe pse i kish dalë një çiban tëpkë

nën koc. As qenia nënshtetas grek, rrjedhimisht imperialist-monarko-fashist, që s’e detyronte dot të ndiqte modën tonë, domethënë modelin homo-socialist, s’e pengoi Pjetër Kokën t’i fuste një hu mirditorçe dhe një muaj birucë. Kundërshtisë dhe insinuatës së Vasilit për mjekrat dhe mustaqet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, operativi Fejzi Liço iu përgjigj me dy javë të tjera, gjersa ... iu shërua çibani.”

“Saga e dhimbjes”- Ditare, kujtime

Fatbardha MULLETI SARAÇI




Pas librit “Kalvari i grave në burgjet e komuniste”, që është një përmbledhje me historitë e grave shqiptare që vuajtën në burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste, dhe që vazhdon te këtë shumë jehonë duke ngjallur interesin e medias dhe studjuesve shqiptarë dhe të huaj, zonja Fatbardha Saraçi vjen këtë herë para lexuesit me një jetëshkrim të saj in të titulluar “Saga e dhimbjes”.

Në këtë përmbledhje ditaresh dhe kujtimesh, që në dukje është diçka më private, na jep mundësinë që përmes përvojës së saj, të kuptojmë mjetet e diskriminimit dhe sfidën e të mbijetuarit si një e “deklasuar”. Ashtu siç merret me mend, duke qenë e mbesa e njërit nga personalitetet politikë të paraluftës, e kryebashkiakut Qazim Mulleti (i cili me ardhjen e komunistëve në pushtet u kategorizua si kriminel luftime, si armik, dhe madje edhe u parodizua nga propaganda), ajo u përball me privime të vazhdueshme, duke u detyruar të ndërrojë edhe mbiemrin, derikur përfundoi si të gjithë viktimat e tjera të luftës së klasave, punëtore në një fabrikë dhe

shënjestër e organizatave të masave. Historia personale ndërthuret me fatet e shumë njërëzve të tjerë të ngjashëm me të saj in, me personazhe të tjerë historikë, për të cilët dihet pak ose aspak duke e zgjeruar rrethin e informacionit. Dhe ç’është më e rëndësishmja, përmes këtij rrëfimi arrijmë të bëjmë një autopsi të atij regjimi, lidhur me mosrespektimin e privacisë, indoktrinimin masiv, dhe përçarjen që mbolli propaganda komuniste në shoqëri me ndarjen dhe kundërvënien klasore . Fotot, dokumentet origjinale që mbështesin rrëfimin e saj, jo vetëm që e familjarizojnë me tepër lexuesin me realitetin e asaj kohe, por edhe e bëjnë të pakontestueshëm këtë rrëfim.

“Mos harroni, jemi edhe ne!” - Artikuj dhe Kumtesa (1991-2010)

Reshat KRIPA



“Kanë kaluar mbi njëzeteshtatë vjet nga përmbyjsja e madhe, dhe ende shqiptarët e shohin kundërshtarin politik si armik, njëlloj si dikur kur na shikonin të tillë neve që hoqëm mbi shpinat tona tmerret e atij sistemi.”- e argumenton arsyen që e nxiti të shkruajë e të botojë këtë përmbledhje, autori Reshat Kripa, i cili është jo vetëm një ish i burgosur politik dhe jo i vetmi në familjen e tij, por edhe një nga drejtuesit e Shoqatës së Ish të Përndjekurve Politikë, një pozicion që i ka dhënë atij mundësinë që përmes kontakteve dhe dokumentacionit, ta njohë me themel gjithë historinë e persektuimit komunist në Shqipëri. Pjesa më e madhe e eseve në këtë libër, sjellin ngjarje dhe personazhe realë, me një simbolikë të veçantë në qëndresën e tyre morale ndaj regjimit; një pjesë tjetër janë reflektime të autorit mbi realitetin post-komunist dhe qëndrimin ndaj të shkuarës komuniste, gjë që sipas tij përcakton edhe përçarjen e shoqërisë së sotme. “E

pra, pikërisht ne duam ta pëmbysim këtë mentalitet. Por, a do të mundim? Është shumë e vështirë. E vështirë sepse shohim që ende një pjesë e shoqërisë shqiptare kërkon ta kalojë në heshtje periudhën totalitare, sepse ende hezitohet të flitet për shumë figura të njohura të historisë shqiptare që i kanë dhënë shumë këtij vendi”.

“Krahë të këputur”, pjesa II – Memuar

Alma LIÇO

Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit



Para dy vitesh, ISKK botoi vëllimin e parë të kujtimeve të Alma Liços (Mirakajt), të titulluar “Krahët të këputur”, në të cilin përshkruhet karvani i gjatë i vujtjeve në tre breza, i një familjeje korçare. Historia tregohet përmes pinjollës së familjes, përmes zërit të një gruaje, gjyshi i së cilës, avokat i shkolluar në Harvard, ishte ekzekutuar si Ballist nga regjimi, në vitin 1945. Rasti i familjes Liço, është një ekzemplar i fatit të të gjitha familjeve të persekutura, i shoqëruar me internime, nxjerrje nga shtëpia, mohim i të drejtës për shkollim, refuzim social, diskriminim që në moshë të vogla, privim nga e drejta e përzgjedhjes së profesionit dhe punës, përveçse punës së rëndë të krahut në bujqësi, ndërtim dhe fabrika. “Katër vite më parë, një zë i brendshëm me orientoi të ulesha dhe të shkruaja historinë e vuajtjeve të mija dhe ato të familjes sime, të jetuara në terrorin komunist. Ndjeva se kisha hipur mbi një varkë e cila lëkundej nga erërat e dilemës dhe pasigurisë. A do mundesha vallë të përshkruaja përjetimet e jashtëzakonshme të asaj periudhe mizore? Kujtimet ishin aty, në zemrën dhe mendjen time, të arkivuara me shumë kujdes. Dhe unë

fillova të shkruaj. Ishte një përjetim i mrekullueshëm. Po nxirrja jashtë vetes gjithë helmin e atyre viteve të mallkuara.”- shpjegon në hyrjen e librit autorja.


Përmes një rrëfimi të gjallë dhe mbresëlënës, ajo na sjell përjetimet e një fëmije, së cilës për motive absurde bota i shkatërrohet brenda ditës: humb shtëpinë, qytetin, ëndrrat, të ardhmen; përjetimet e një fëmije, që kushtet e tmerrshme e pjekin para kohe. Densiteti i ngjarjeve dhe detajeve, e bën librin një objekt tepër interesant studimi mbi natyrën e fshatrave të internimit të asaj kohe. Libri mbyllet me një episod edhe më interesant: kthimin në vendin e internimit pas pothuajse 30 vjetësh, e shoqëruar me një ekip televiziv gjerman, i cili po realizon një dokumentar për të. Përballja tronditëse me të shkuarën, arrin edhe pikën më dramatike të ngjarjes.

2.3 LITERATURË NGA BURGJET DHE KAMPET

”Grabjani rrëzë kodrave”- ditar

Skena, personazhe, historira nga fshati i internimit në vitet '70-'80

Lekë TASI



Libri “Grabjani mes kodrave”, është një nga dëshmitë më interesante të viteve të diktaturës. Bëhet fjalë për ditarin e piktorit Lekë Tasi, pjesëtar i familjes së madhe patriotike Tasi, kalvari i eliminimeve, burgosjeve, internimeve, sekusterimeve dhe të gjitha formave të tjera të persekutimit të së cilës, filloi që në vitin 1945, dhe zgjati deri në rënien e regjimit komunist. Veçantia kryesore e këtij libri është se është shkruar në formë ditarin në kohën që kanë ndodhur ngjarjet, gjatë një harku kohor prej dhjetë vjetësh, pra nga 14 tetor 1975 deri më 21 tetor 1985, periudhë gjatë së cilën familja ndodhej e internuar në fshatin Grabjan të Lushnjes.

Përmes këtij rrëfimi, Lekë Tasi na ka dhënë një tablo të plotë të kampit të Grabjanit, si një miniatyrë e një kampi tipik internimi politik, me punën, strehimin, organizimin e brendshëm, kodet morale dhe kodet e komunikimit që kishin përshtatur të internuarit në mes tyre, mekanizmat e kontrollit dhe të presionit të pushtetit mbi të internuarit, etj. Përshkrimi i kampit

të Grabjanit paraqet një interes të veçantë edhe për të njohur valët e luftës së klasave në Shqipërinë komuniste, duke qenë njëri nga kampet ku ishin mbledhur ata që konsideroheshin “armiqtë tradicionalë” të regjimit, pra, familjet nacionaliste persekutimi i të cilëve filloi që në vitin 1945, e deri tek grupet armiqësore të shpallura herë pas here, nga vetë radhët e pushtetarëve. Ndaj edhe shpesh gjejmë histori brenda historisë. Në Grabjan hasim sa personazhe të rastit, po aq edhe figura të njohura; gjejmë ngjarje, përshkrime autentike, që vijnë të skicuara më shumë vitalitet por edhe paanaësi, dhe janë pikërisht ato që e bëjnë aq të besueshëm këtë rrëfim. Në hapje të ditarit, autori shkruan: “Dua t’i shënoj ngjarjet që do vijnë, si një spektator i mënjanuar; që me to të formoj më pas një histori, një nga të shumtat e kësaj epoke, që është e mbushur me të tilla, fate njerëzish në qytet e në fshat dhe sidomos në vendet e mbyllura, burgje e kampe, një sferë kjo mjaft e njohur për familjen tonë nga e cila ishim shkëputur prej disa vitesh dhe që tani po na gllabëron sërish.”

Libri na njeh veçanërisht për kushtet çnjerëzore fizike po aq edhe psikologjike në të cilat trajtoheshin të internuarit politikë, si në këtë paragraf: “Qysh më pesë të mëngjesit, natë akoma, na zgjon megafoni që transmeton muzikë popullore. Dalim në kërkim të një nevojtojeje. Mamanë e çojmë ndër komshinj por kanë filluar të bezdisen.”

3. KONFERENCA/KUALIFIKIME

3.1 KONFERENCA TË ORGANIZUARA NGA ISKK

20 Shkurt 2018: “JU FLET RADIO...”- Konferencë mbi 27 vjetorin e rënies së komunizmit

Në përkujtim të 20 shkurtit 1991, ditës kur u rrëzua busti i diktatorit, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer, organizuan konferencën e përbashkët “JU FLET RADIO...”-

Konferenca u realizua ne tri sesione, sipas këtij programi:

Fjala e hapjes: Walter Glos, Drejtor i KAS; Agron Tufa, Drejtor i ISKK

Sesioni I: Diskutim në panel: „20 shkurti në objektivin e mediave ndërkombëtare“

Të ftuar në panel: Elez Biberaj, “Zëri i Amerikës”; Franz Gustincich, gazetar i pavarur i pranishëm në ngjarjet e 20 shkurtit 1991; Besnik Mustafaj, gazetar për AFP në vitin 1991; Vilma-Filaj Ballvora, “Deutsche Ëelle”; Nevena Marcic, Kryeredaktore e “Tanjug”
Moderator i diskutimit: Blendi Fevziu, Gazetar

Sesioni II. Prezantim i veprave te reja dokumentuese të ISKK mbi krimet e komunizmit

Ligjëruan: Agron Tufa, Ermira Xhomaqi, Fatbardha Mulleti, Neritan Ceka, Sohrat Shyti, Vasfi Baruti, Enver Memishaj, Shkëlqim Abazi, Uran Butka.

Sesioni III. Qasja ndaj historisë së komunizmit: sfida dhe strategji

Enriketa Papa – Universiteti i Tiranës:

"Përpjekjet e programeve studimore-universitare, mbi qasjen shkencore të krimeve të Komunizmit"

Çelo Hoxha – Drejtor i Arkivës në ISKK:

“Krijimi i database dhe arkivës dokumentuese”

Bilal Kola- Drejtor i IIPP:

"Iniciativat dhe sfidat e IIPP në rehabilitim moral të ish-të përndjekurve"

Përfaqësuesi i Autoritetit të Hapjes së Dosjeve:

"Në shërbim të dokumentave sekrete për njohjen e persekutimit komunist"

Nebil Çika - Kryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politikë Demokratë:

"Informacioni mbi krimet e komunizmit në kushtet e mungesës së një periodiku ekskluziv"

Jonila Godole – Drejtuese e IDMC:

"Mbi rolin dhe ndihmesën e IDMC-së për vetëdijësimin e të rinjve mbi diktaturën komuniste dhe trashëgiminë e saj”

Erald Kapri – gazetar:

"Përvoja personale me dosierët në zbardhjen e Krimeve të komunizmit".

28 mars 2018: Tubim shkencor me rastin e përvjetorit të lindjes së poetit-martir Vilson Blloshmi

Me rastin e përvjetorit të lindjes së poetit-martir Vilson Blloshmi, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit organizoi një tubim shkencor në Akedeminë e Shkencave, me ç'rast u promovua edhe libri "Saga e Blloshmeve" të Bedri Blloshmit. Ky botim shkon përtej historisë së njohur të ekzekutimit të poetit; aty përmblihen fakte dhe dokumenta që ilustrjnë përndjekjen e një fisi të tërë, në tre breza, për arsye politike, dhe se si rasti i Vilsonit ishte thjesht pjesë e një plani eliminimi.

28 prill 2018: Konferencë Ndërkombëtare "Krimet e Komunizmit në Shqipëri, pasojat dhe përballimi me to në situatën e sotme"

ISKK zhvilloi një konferencë një-ditore me pjesëmarrjen e 13 studiuesve, aktivistëve të shoqatave mbi të drejtat e njeriut nga Gjermania dhe Europa. Emrat e pjesëmarrësve në këtë konferencë të zhvilluar në hollin e ISKK janë:

- Ilira Aliai ConAct - German Israeli;
- Youth Exchange Viktoria Blaho German;
- War Graves Commission Marta Kurek German;
- National Agency for the EU-Programme Erasmus + Youth Martin Glazar;
- Historian Kita Boncheva;
- YMCA Dobrich (youth NGO) Giorgos Monogioudis;
- Embassy of the Federal Republic of Germany in Athens Katarzyna Lorenc Engelage & Lieder;
- Art Gallery Svetlana Kirova EU-Russia;
- Civil Society Forum Szilvia Gelai;
- Egon Zehnder Institute Julia Suchar Villa;
- Fohrde Cultural and Educational House Ania Lysiak;
- German-Polish Youth Office Nina Linkel;
- Bosch International Alumni Magazine Marco Schwarz;
- Friedrich-Ebert-Foundation EU Office.

21 maj 2018: Konferencë përkujtimore në Ish Kamp-Burgun e Spaçit

Me rastin e 45 vjetorit të revoltës së Spaçit, ISKK në bashkëpunim me fondacionin "Drejtësi dhe paqe" (Justice and Peace Commission of Albania) në Shkodër, organizuan një konferencë përkujtimore në Kamp-Burgun e Spaçit. Të ftuar nga ISKK ishin ish të burgosur të këtij kampi, protagonistë të Revoltës, të cilët me fjalën e tyre në konferencë risollën në vëmendje përvojat e tyre në këtë kamp, punën e rëndë dhe trajtimin mizor. Ata dhe personalitetet e ftuar në konferencë, argumentuan nevojën e kthimit të këtij kampi në muze të krimeve të komunizmit, si dëshmi dhe gjest vetëdijësimi publik.

9 qershor 2018: Sesion shkencor-përkujtimor për poetin Havzi Nela

ISKK në bashkëpunim me bashkinë e Kukësit dhe Klubin e Poezisë organizuan ceremoninë e përrurimit të bustit të poetit martir Havzi Nela para gjimnazit publik që mban emrin e tij dhe sesionin shkencor-përkujtimor për poetin në Sallën e Pallatit të Kulturës së qytetit, me praninë e shkrimtarëve dhe studiuesve shqiptarë.

14 qershor 2018: “Jehona e gjatë e diktaturës” – aktivitet shkencor i mbajtur në Shkodër

ISKK në bashkëpunim me Shoqatën e ish të Përndjekurve Politikë të Shkodrës, në ambjentet e bibliotekës “Marin Barleti” në Shkodër, zhvilluan konferencën “Jehona e gjatë e diktaturës”. Ligjërues, studjues dhe ish të burgosur politikë, në qendër të diskutimit të tyre u ndalën kryesisht në periudhën post-totalitare, e parë nga këndvështrimi i pasojave që komunizmi pati në shoqërinë shqiptare. Në një sesion të posaçëm u bë promovimi i kolanës prej 24 titujsh të botimeve vjetore të ISKK. Sesionin shkencor u drejtua nga Agron Tufa, drejtor ekzekutiv i ISKK dhe z. Zenel Drangu, Kryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politikë të Shkodrës. Aktiviteti u pasqyrua në mediat lokale dhe qëndrore.

23 qershor 2018: Homazh dhe sezon shkencor përkujtimor për viktimat e 26 shkurtit 1951

ISKK në bashkëpunim me Institutin e Studimeve "Lumo Skëndo" dhe familjarë të viktimave të 26 shkurtit 1951, organizuan homazhe në vendin ku 25 vjet më parë u gjenden eshtrat e 22 martirëve të masakruar nga diktatura komuniste. Pas homazheve, në sallën "Unesco" të Muzeut Historik Kombëtar, u mbajt një sesion shkencor- përkujtimor, ku u sollën edhe fakte të reja të zbuluara së fundmi në arkiva, që hedhin dritë mbi ngjarjen.

17 korrik 2018: Konferencë në Bashkinë e Librazhdit

ISKK në bashkëpunim me Bashkinë e Librazhdit, zhvilloi një konferencë, në të cilën u promovua kolana e botimeve të vitit 2017, duke u ndalur më gjatë në veprën "Saga e Blloshmëve nën terrorin komunist", që lidhet simbolikisht me këtë qytet. Aktiviteti u organizua si homazh me rastin e pushkatimit nga diktatura komuniste, të dy poetëve martirë të Librazhdit.

10 gusht 2018: Takim përkujtimor në bashkëpunim me Bashkinë e Kukësit

Në bashkëpunim me Klubin e Poezisë dhe Bashkinë e Kukësit, ISKK organizoi një tubim në Ditën Përkujtimore (30 vjetorin) të ekzekutimit me varje të poetit martir Havzi Nela. Në agjendën e këtij takimi përfshiheshin: homazhe tek përmendorja e poetit në Kukës; fjala e drejtorit të ISKK, z. Agron Tufa, në ceremonia e përrurimit të shtëpisë së poetit në vendlindjen e tij, Kollovoz; prezantimi i numrit special të revistës "ILLZA" me krijimtarinë e poetëve martirë nga Shqipëria dhe Bota dhe e almanakut me përmbledhje shkrimesh kushtuar poetit martir Havzi Nela.

16 nëntor 2018: Tubimi përkujtimor “Terrori i një kryeqyteti”

Me rastin e 74-vjetorit të pushkatimit pa gjyq në Tiranë të 37 intelektualëve nga komunistët pa ardhur akoma në pushtet, ISKK në bashkëpunim me Shoqatën e Ish të Përndjekurve politikë, zhvilluan një tubim përkujtimor në një nga sallat e Akademisë së Shkencave. Disa nga viktimat e pafajshme të këtij terrori, ishin intelektualët Nebil Çika, Ali Panariti, Anton Fekeçi, Jakup Deliallisi, Akil Sakiqi, Lluka Xhumari, Boris Beleski, Nazmi Uruçi, Hamit Greblleshi, Abdulla Saraçi, Sybi Topalli, Muharrem Liku, Rakip Kalenja, Muntaz, Vesim e Syrja Kokalari, etj. Organizuesit e këtij tubimi, tok me familjarë e qytetarë të tjerë u mbledhën në orën 12.00, pranë memorialit të 37 viktimave të komunizmit për të bërë homazhe. Më pas, aktiviteti vijoi me një konferencë ku ligjëruesit analizuan skemën asaj ngjarjeje, të pasuruar me fakte të reja, dhe të parë nga këndvështrimi i sotëm.

5 dhjetor 2018: Prezantohet libri “Një jetë me brenga” i Prof. Kolec Topallit

Me rastin e botimit të përmbledhjes me kujtime “Një jetë me brenga” të profesor Kolec Topallit, ISKK organizoi një konferencë në Akademinë e Shkencave pikërisht me datë 5 dhjetor, që përkonte edhe me 80 vjetorin e lindjes së tij. Në këtë konferencë u argumentua që në këtë figurë gërshetohen jo vetëm vuajtjet e një njeriu të përndjekur nga diktura, por edhe e një gjuhëtari, i cili pavarësisht privimit nga e drejta intelektuale, nuk e rreshti kurrë punën e tij kërkimore. Ashtu siç pranuan edhe shkrimtarët dhe studjuesit në sallë, vepra dhe publicistika e tij konsiderohet një nga më profesionale dhe më të rëndësishmet e lëmit të gjuhësisë shqiptare. Akademiku Kolec Topalli është autor i mbi 20 librave me studime gjuhësore. Një ndër veprat e fundit të tij dhe më të rëndësishmet e karrierës është “Fjalori etimologjik i gjuhës Shqipe”.

3.2 BASHKËPUNIME/ PJESËMARRJE NË KONFERENCA

13 maj 2018: Pjesëmarrje në konferencën "Roli i Mit'hat Frashërit në parandalimin e ideve bolshevike komuniste në Shqipërinë e prag luftës së Dytë Botërore".

Nw promovimin e veprës së Mit'hat Frashërit në sallën e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Drejtori i ISKK, Shqipëri, z/ Agron Tufa, mbajti kumtesën "Roli i Mit'hat Frashërit në parandalimin e ideve bolshevike komuniste në Shqipërinë e prag luftës së Dytë Botërore.

23 maj 2018: Ligjëratë në Fakultetin Filologjik të Prishtinës

I ftuar nga Fakulteti Filologjik i Prishtinës, Drejtori i ISKK, Shqipëri, z. Agron Tufa mbajti ligjëratën "Letërsia dhe Diktatura".

16 maj 2018: Pjesëmarrje në seancën dëgjimore të Komisionit tëp Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, për raportin e OSBE mbi të zhdukurit.

16 korrik 2008: Konferencë ndërkombëtare "Zbardhja e krimeve të Komunizmit në Epokën Digitale".

Konferenca ndërkombëtare me titull "Zbardhja e krimeve të Komunizmit në Epokën Digitale", e organizuar nga fondacioni i arkivave online "KUJTO" dhe e mbajtur në Tiranë, u bazua në disa linja diskutimi: zbulimi i krimeve të komunizmit përmes mjeteve të reja të komunikimit, një potencial i ri; përfshirja e qytetarëve në një model të ri kontributi për njohjen e krimeve të diktaturës komuniste; shoqëria shqiptare përballë të kaluarës në ditët e sotme, nga përballja me krimet tek nevoja për një qasje ndryshe ndaj diktaturës.

Në konferencë referuan edhe Dr. Pavel Zaçek historian, themeluesi dhe drejtori i parë i Institutit të Studimeve të Regjimeve Totalitare dhe Arkivave të Departamenteve të Sigurisë në Çeki; Prof. z. Agron Tufa, drejtor i ISKK; Lori Amy, profesore në Departamentin e Shkrimit dhe Linguistikës në Universitetin Jugor të Xhorxhias në SHBA; Prof. Uran Butka, dhe z. Agron Shehaj.

14 gusht-18 gusht 2018: Projekti ndërkombëtar "On the traces of socialism in Serbia"

Fondacioni Konrad Adenauer në Serbi, me 14 gusht-18 gusht 2018, organizoi projektin ndërkombëtar "On the traces of socialism in Serbia", në të cilin ishin të ftuar artistë dhe aktivistë nga rajoni. Aktiviteti konsistonte në një workshop lëvizës pesë-ditor, nëpër shtet e socializmit në Serbi. Znj. Luljeta Lleshanaku, drejtore e Drejtorisë së Studimeve në ISKK pjesëmarrëse në këtë konferencë dhe njëkohësisht ideatore e projektit "Në ndjekje të gjurmëve të komunizmit në Shqipëri" që u realizua gjatë vitit 2017, ndër të tjera bëri edhe një prezantim të këtij projekti në seancën e hapjes së workshop-it, duke e ilustruar me përvojën e menaxhimit të trashëgimisë materiale komuniste në Shqipëri.

23 gusht 2018: Dita Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare në Tepelenë

Me rastin e Ditës Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, Autoriteti për Informim të Dosjeve të Ish Sigurimit të shtetit (AIDSSH) zhvilloi një cikël aktivitesh në ish kampin e internimit të Tepelenës në të cilin ISKK përfaqësohet me:

- a) ligjëratën "Persekutimi komunist në rrethin e Tepelenës" (mbajtur nga Çelo Hoxha, Drejtor i Drejtorisë së Arkivës në ISKK)
- b) ekspozitë me piktura e portrete me temë nga kampet e internimeve komuniste
- c) video-regjistrime të dëshmimeve nga të mbijetuarit e kampeve e burgjeve komuniste, d) video-interpretime me monologje e histori të shkruara nga drejtori i ISKK, Agron Tufa, referuar mbi ngjarje të vërteta.

30 gusht, 2018: Bashkëpunim me Autoritetin Për Hapjen e Dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit për projektin "Edhe Muret Kanë Veshë"

ISKK bashkëpunon me Autoritetin Për Hapjen e Dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit, për projektin "Edhe muret kanë veshë", qëllimi i të cilit është nxitja e debatit në shoqëri dhe ndërgjegjësimi i brezit të ri mbi të shkuarën komuniste. Ideatorja e këtij projekti Alketa Xhafa, e ka konceptuar

projektin si një instalacion lëvizës, përmes projektimit në ambiente publike të “heronjve të heshtur”, të pasazheve më domethënëse mbi vuajtjet e të mbijetuarve në burgjet dhe kampet e komunizmit.

11-12 Shtator 2018: Pjesëmarrje në konferencën TAIEX Multi-Country mbi Trashëgimitë e së Shkuarës, në Bruksel

Në konferencën e TAIEX Multi-Country mbi Trashëgimitë e së Shkuarës, organizuar nga Komisioni European, si Bashkëpunim Rajonal i Ballkanit Perëndimor, në Bruksel me 11-12 shtator 2018, drejtori ekzekutiv i ISKK, z/ Agron Tufa mori pjesë në tryezën e diskutimeve dhe zv/ Drejtore e Bordit të ISKK Jonila Godole u paraqit me kumtesën: "Roli i shoqërisë civile në ballafaqimin me të shkuarën komuniste".

12 tetor 2018: Panel diskutimi “Si hapet një arkivë e shërbimit sekret?” në Frankfurt, Gjermani

Rrjeti TRADUKI në bashkëpunim me OSTEUROPA, organizuan në Panairin Ndërkombëtar të Librit e në Frankfurt, diskutimin me temë “Si hapet një arkivë e shërbimit sekret?”, ku morën pjesë: Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i Institutit të Studime të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri dhe shkrimtar; Germina Nagat (Rumani) përgjegjëse për dosjet e shkrimtarëve pranë autoritetit rumun për hapjen e dosjeve; Manfred Sapper (Gjermani) Kryeredaktor i OSTEUROPA (revistë për politikën, kulturën, ekonominë dhe shoqërinë në Evropën Lindore), Ilija Trojanoë (Austri/Bullgari) shkrimtar.

Duke qene që në Evropën Juglindore, përpjekjet për të trajtuar trashëgiminë e komunizmit kanë përparuar me ritme shumë të ndryshme, dhe paneli diskutoi pikërisht mbi gjendjen aktuale dhe pranimin social në Shqipëri, Bullgari dhe Rumani të kësaj trashëgimie. U diskutua gjithashtu mbi rëndësinë e rolin e shoqërisë civile, si dhe roli mbështetës i Gjermanisë.

Tetor 2018: Filmi dokumentar “Azizi” (Premierë)

ISKK ka bashkëpunuar me producenten dhe skenaristen e filmit dokumentar “Azizi”, z. Luljeta Progni, premiera e të cilit u dha në kinema “Milenium” me 25 tetor 2018.

Historia e filmit përshkruan kampet me tela nga 1945 deri në 1954, dhe ndalet kryesisht në kampin e Tepelenës, i cili qe edhe më i tmerrshmi në llojin e vet, për shkak të kushteve ekstreme, urisë, sëmundjeve dhe vdekjeve të shumta. Drama rrëfëhet përmes njërit nga të mbijetuarit, infermierit të kampit, zotit Aziz Ndreu, emrin e te cilin mban edhe vetë filmi.

Skenari i filmit është bazuar mbi rrëfimet e të mbijetuarve, duke iu referuar një pjese të konsiderueshme dëshmive të mbledhura nga ISKK, dhe të botuara në kolanën “Zërat e Kujtesës”, që ishte edhe mënyra e bashkëpunimit të ISKK me grupin e produksionit.

26 tetor 2018: Konferenca ndërkombëtare “DITËT E KUJTESËS 2018: Identiteti dhe Kujtesa” (Edicioni i 3të)

Në konferencën ndërkombëtare “DITËT E KUJTESËS 2018” të organizuar nga IDMC në Tiranë më 22– 31 tetor 2018, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit prezantoi Vëllimin e VII të “Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist”. Prezantimi u bë nga Çelo Hoxha, zv/Drejtor dhe Pergjegjes për Arkiven në ISKK.

29-31 tetor 2018: Konferencë ndërkombëtare “Të mohuar nga regjimi”: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, me 29-30 tetor organizoi konferencën ndërkombëtare shkencore me temë: “Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990”.

Në këtë konferencë, Zv.Drejtori i ISKK Çelo Hoxha, mbajti kumtesën : “Ligjshmëria e procesit të internim-dëbimeve.” Pjesëmarrës në panelet e diskutimit të kësaj konference, kanë qenë të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Arkivës.

1 Nëntor 2018: Vizitë zyrtare e drejtorit të ISKK, z. Agron Tufa në Federatën Panshqiptare "Vatra" në New York.

Drejtori i ISKK, z Agron Tufa ftohet për një vizitë nga Federata Panshqiptare "Vatra" në New York, ku ndër të tjera u njoh me aktivitetin e kësaj shoqate mjaft të rëndësishme të diasporës, dhe i njohu të pranishmit mbi përvojën e ISKK në lidhje me zbardhjen e krimeve të komunizmit 27 vjet pas rënies së diktaturës. Në këtë takim, ai mbajti një ligjëratë me temë "Mbi riaktivizimin e ish-Sigurimit të shtetit komunist në institucionet shtetërore dhe segmentet e tij në Diasporën shqiptare". Gjatë takimit u fol edhe për një bashkëpunim të ndërsjellë mes Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat të Komunizmit me Federatën “Vatra”.

7 -10 nëntor: Prezantim në Panairin e Librit në Vienë

I ftuar në Panairin e Librit “Buch Wien e Österreichische Gesellschaft für Literatur”, drejtori i ISKK diskutoi në panelin „Shqipëria mes së djeshmes e së nesërme“ mbi trashëgiminë e diktaturës dhe përvojën tonë institucionale - format e përballjes me të.

Më pas, në Lidhjen e Shkrimtarëve të Austrisë, u mbajt një takim me temë: “Shqipëria dhe sot”, një aktivitet ky që mbështetej nga Ministria Jashtme e Austrisë dhe rrjeti Traduki, ku Drejtori i ISKK Z.Agron Tufa, pati një performancë me video-tregime nga jeta e kampeve të internimit dhe burgjeve politike të komunizmit. Gjithashtu ai pati një bisedë një-orëshe me shkrimtarët dhe intelektualët austriakë. Merrte pjesë i pranishëm dhe ambasadori ynë në Vjenë, z. Bime.

15 nëntor 2018: Prezantim në Konferencën shkencore “Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës komuniste, 1945-1953” në Shkodër

Këshilli i Qarkut Shkodër, me 15 nëntor, zhvilloi në ambjentet e Hotel Rozafës konferencën shkencore “Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës komuniste, 1945-1953”. Drejtori i Arkivës së ISKK, z.Çelo Hoxha, në këtë konferencë mbajti kumtesën: “Ligjshmëria e veprimeve të ushtrisë partizane në Shkodër, Kukës, dhe Dibër, dhjetor 1944-mars 1945”.

26 nëntor 2018: Ligjëratë mbi veprën e Mid'hat Frashërit

Në takimin që KLSH zhvilloi mbi veprën e Mid'hat Frashërit, drejtorin i ISKK z.Agron Tufa mbajti ligjëratën "Demonizme dhe falsifikime të historiografisë komuniste mbi imazhin e Mit'hat Frashërit".

27 nëntor 2018: Veprimtaria kulturore me temë “Letërsia dhe vuajtja”

Shoqata "Përpjekje" në bashkëpunim me Bibliotekën publike “Marin Barleti”, organizuan veprimtarinë kulturore me temë “Letërsia dhe vuajtja” ku i ftuar ishte Drejtori Ekzekutiv i ISKK z.Agron Tufa. Gjatë takimit u shfaqën 20 video-tregime rreth historive reale të Kampeve komuniste të internimit dhe u mbajt kumtesa "Letërsia dhe vuajtja".

30-31 nëntor 2018 – Konferencë shkencore ndërkombëtare “Të mohuar nga regjimi komunist”

Autoriteti për informim mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin e Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë, me 30-31 nëntor, organizoi konferencën ndërkombëtare “Të mohuar nga regjimi komunist”.

Zv.drejtori i ISKK Çelo Hoxha, mbajti në këtë konferencë kumtesën: “Ligjshmëria e procesit të internim-dëbimeve.”

3.3 TAKIME

1 gusht 2018: Vizitë e pianistes shqiptaro-amerikane Dr. Elida Dakoli (USA) në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK)

Pas disa vizitave dhe takimeve me Znj. Vasilika Hysi, Zv/Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë dhe me znj. Lindita Nikolla, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pianistja Elida Dakoli pati me datë 1 gusht 2018, një takim të përzemërt në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. Znj. Elida Dakoli vjen nga një familje e persekutuar gjatë diktaturës komuniste.

Pasi u njoh me projektet dhe punën e madhe që ka bërë dhe bën Instituti në zbardhjen e Krimeve të Komunizmit, znj. Dakoli ofroi gatishmërinë e saj për t'u bërë pjesë e misionit të Institutit tonë në zbardhjen e krimeve të komunizmit, përmes angazhimit të saj konkret në lidhjen e Institutit me organizatat dhe fondacionet kërkimore mbi krimet dhe viktimat e komunizmit, që ekzistojnë në SHBA.

3.4 AKTE ZYRTARE

Prill 2018: Kërkesë Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Monumenteve për shpalljen e ish Kampit të Internimit me tela me gjemba, Tepelenë, si objekt muzeal me status të paprekshëm nga ndërhyrjet eventuale tjetërsuese. Përgjigja ka qenë pozitive dhe vendimi është marrë duke e shpallur territorin e Kampit të internimit "objekt në mbrojtje të veçantë shtetërore"

Maj 2018: Kërkesë Ministrisë së Kulturës, Institutit të monumenteve dhe Bashkisë së Librazhdit:

Në vijim të korrespondencave tona të mëparshmet, si dhe në kuadër të legjislacionit të ri, bazuar në nenet 201, 202, të ligjit nr.27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", ISKK propozon krijimin e muzeve të rinj kombëtar si më poshtë:

1-Muzeu Kombëtar Reparti nr.303 Spaç. Në vitet 1968-1990 në këtë kamp pune kanë vuajtur dënimin me punë të detyruar një pjesë e madhe të dënuarve politikë.

2- Muzeu Kombëtar Kampi i Internimit tela me gjemba Tepelenë. Në vitet 1949-1953 në këtë kamp u izoluan, vuajtën dënimin dhe vdiqën gra, pleq dhe fëmijë, të afërm të kundërshtarëve të regjimit.

3. Muzeu Kombëtar i poetëve martirë "Vilson Blloshmi dhe Genc Leka", duke rekonstruktuar shtëpinë-kullë të Blloshmëve, që është në pronësi të z. Bedri Blloshmi. Pas rindërtimit dhe plotësimit me botime e dokumente, Shtëpia-muze e poetëve martirë mund të kthehet në një Qendër peligrinazhi në çdo 17 korrik, ku të mbahet një Festival unik i Poezisë me pjesëmarrje të poetëve nga Europa dhe Bota. Këtij koncepti i janë bashkangjitur që heret një numer i madh poetësh
shqiptarë.

Për këtë kërkesë nuk morrëm kurrë përgjigje, ndërkohë që nga Bashkia e Librazhdit morëm përgjigje pozitive dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar.

Në zbatim të detyrave ligjore dhe hapësirave të ligjit tonë ISKK është përpjekur të trajtojë ligjërisht çështje të rëndësishme të kujtesës publike në lidhje me realitetin e persekutimit komunist në funksion të edukimit qytetar të brezave në bashkëpunim me institucionet e pushtetit qëndror

28, 9. 2018- Kërkesë Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj për Një Kërkesë- Propozim për krijimin dhe vendosjen në Tiranë të një një basoreliefi me subjekt katër heronjtë e qëndresës antikomuniste, që ranë dëshmorë në Revoltën e burgut të Spaçit me 21 maj 1973.

Ashtu si për kërkesat e viteve të mëparshme, nuk na është kthyer përgjigje.

18.10. 2018- Propozim Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj "për vendosjen e një rruge emrin e martirit Manush Peshkëpia (1910 - 1951), të pushkatuar pa gjyq në mesnatën e 26

shkurtit të vitit 1951". Si gjithmonë, as për këtë kërkesë, të përsëritur që nga viti 2017, nuk kemi marrë përgjigje.

Akte te tjera:

1 maj - 1 shtator 2018- Hartimi i një Draft-projekti Propozimi drejtuar Parlamentit mbi dekomunistizimin e simbolikes ne hapësirën publike (1 maj - 1 shtator 2018)

Maj 2018- Deklaratë për Shtyp dhe njëherësh Letër e Hapur e ISKK drejtuar krerëve të shtetit (Presidentit, Kryeparlamentarit, Kryeministrit, krerëve të partive politike dhe Kryeprokurores, si dhe përfaqësive diplomatike të akredituara në Shqipëri), mandej e botuar me 6 maj në gazetën "Panorama", mbi manifestimin e Veteranëve dhe Partisë Komuniste me portrete të Diktatorit Hoxha dhe simole të komunizmit në Varrezat e Dëshmorëve.

3.5 TRAJNIME

14 shkurt 2018: Seminar trajnimi një-ditor tek Muzeu “Shtëpia e gjetheve”

Muzeu “Shtëpia e gjetheve”, në bashkëpunim me Prezencën e OSCE në Tiranë, organizoi një seminar trajnimi një-ditor me dëshmitarë të persekutimit komunist në Shqipëri. Ky seminar kishte si qëllim trajnimin e dëshmitarëve dhe aktorëve të historisë së persekutimit politik në Shqipëri mbi mënyrën se si të shoqërojnë nxënës dhe student gjatë vizitave në Muzeun: shtëpia e gjetheve”. Gjithashtu ky trajnim sunonte të krijojte një format standard mbi të cilin do të zhvilloheshin vizitat e grupeve të reja në këtë muze.

Pjesëmarrës në trajnim: Luljeta Lleshanaku, drejtore e Studimeve në ISKK

17- 18 korrik 2018: Seminar trajnimi mbi “zbardhjen e krimeve të komunizmit në epokën digitale”, organizuar nga fondacioni "Kujto"

Në vijim të konferencës me të njëjtin titull, Dr. Pavel Zaçek historian, themeluesi dhe drejtori i parë i Institutit të Studimeve të Regjimeve Totalitare dhe Arkivave të Departamenteve të Sigurisë në Çeki, autor i mbi 120 artikujve shkencorë, monografive dhe publikimeve dhe deputet në parlamentin e Çekisë, trajnoi një grup specialistësh mbi përpunimin e dokumentacionit të krimeve të komunizmit përmes mjeteve të reja të komunikimit në epokën digjitale.

Pjesëmarrës në trajnim: Brunilda Doçi, specialist e II-rë në Drejtorinë e Arkivave të ISKK; Kolë Kamsi, specialist e II-rë në Drejtorinë e Arkivave të ISKK; Pëllumb Alushi, specialist IT në ISKK; Daniel Miraka, përfaqësues juridik në ISKK.

25 tetor 2018: Trajnim për stafet e muzeumeve dhe institucioneve të kujtesës.

Muzeu “Shtëpia e gjetheve”, në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer në Tiranë, organizoi një seminar trajnimi një-ditor për punonjësit e muzeve dhe të institucioneve të kujtesës me zonjën Kristin Kallëit, përfaqësuese e Stiftung Gedenkstätte Berlin- Hohenschönhausen. Ajo ofroi ekspertizën e saj në lidhje me kulturën e kujtesës, mënyrën se si të mbajmë gjallë kujtesën mbi të shkuarën dhe si t’i bëjmë ngjarjet historike të duken interesante, veçanërisht për brezat e rinj.

Pjesëmarrës në trajnim: Daniela Runa, specialiste e I-rë dhe Pëllumb Alushi, specialist IT në ISKK

3.6 PUBLIKIME NË MEDIA

(Artikuj shkencorë, emisione televizive, skenarë, intervista)

- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK: ORA NEWS, Emisioni i Lajmeve, Kronikë speciale, intervistë, 23 shkurt 2018
- Luljeta Lleshanaku, Drejtore e Drejtorisë së Studimeve në ISKK: ORA NEWS, Rubrika Speciale, Emisioni i Lajmeve, intervistë, 23 shkurt 2018
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK: Neës24, Emisioni "Studio e hapur", 3 prill, 2018. Debat mbi Kampin e Tepelenës.
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK: ABC NEWS, emisioni "Provokacija", 17 prill 2018. Bisedë rreth mohimit dhe falisifikimit të Kampeve të deportimit ose kampeve me tela; në fokus ish kampin i internimit të Tepelenës
- Luljeta Lleshanaku, Drejtore e Drejtorisë së Studimeve në ISKK: “Zëri i Amerikës” Studio në New York, intervistë, 9 maj 2018.
- Leka NDOJA, studjues në ISKK: “70 vjet nga ekzekutimi i Alush Sejkos e Dr. Riza Resultit”, portali RadiandRadi, 9 janar 2018.
- Leka NDOJA, studjues në ISKK: “Ismail Abedin Farka, muzgu i jetës së një inxhinieri”, artikull, gazeta Shqiptarja.com; portale, kujto.al, janar-mars 2018.
- Leka NDOJA, studjues në ISKK: Intervistë e Vasil Kokalit: “Mbi internimet në Tepelenë, Turan, Bënçë dhe Luzat”, Gazeta Telegraf, 14 prill 2018; portalet, Time.al, VOAL 15 prill 2018.

- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK: Fax News. Tema: aparati shtypës dhe dhuna në burgjet e komunizmit. Në fokus rasti i ish komandantit të policisë së burgut, më vonë Komandantit të burgut të Qafë-Barit, Edmond Caja, që ka shërbyer aty në vitet 1982-1989, si një rast kur dhunuesi hedh në gjyq viktimën. Intervistë, 4 dhjetor 2018.
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK: emisioni CODEX, KTV Prishtinë. Bisedë mbi rezistencën kulturore të shkrimtarëve të bllokut komunist dhe mbi disidencën. 2 qershor 2018.
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK, gazeta "Shekulli", Agron Tufa, shkrimi me titull: "Pulla" për filmat e socializmit nervozon "ishët". 17. 08. 2017,
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK, polemizon me historianin Pëllumb Xhufi në replikën me titull: "Kë shqetëson e vërteta mbi "Auschwitz-in" shqiptar" të Tepelenës?" 6 prill 2018
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK, i kundërpërgjigjet historianit Pëllumb Xhufi tek gazeta "Mapo": "Pse serbët do e kishin zili Enverin, për Kampin e vdekjes në Tepelenë". 8 prill 2018
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK, artikull në gazetën "Panorama" dhe "Tema": "Pëllumb Xhufi gënjeu për Kampin e Tepelenës dhe manipuloi dokumentat e CIA-s". 2 prill 2018
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK, artikull mbi Kampin e Tepelenës në gazetën "Panorama", 23 shtator 2018.
- Agron Tufa, Drejtor ekzekutiv i ISKK, boton në gazetën "Panorama", Letrën e Hapur drejtuar institucioneve të larta të shtetit me titull: "Bashkimin Europian, apo Krimet e Komunizmit?", ku vë në spikamë manifestimin e falangave enveriste në ditën përkujtimore të dëshmorëve me portretin e diktatorit dhe simbolet e komunizmit; 6 maj 2018.

4 BASHKËPUNIME SHKENCORE/ INTERSHIP

4.1 BASHKËPUNIME STUDIMORE

- Aurora Bega, Doktore e Shkencave
Dega Gazetari, Univeriteti i Tiranës, doktorante
Projekt "POTKAST" i Qendrës për Mbrjtjen dhe Zhvillimin e Medias së Re në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane

- Anjeza Koroni, Kolegji Universitar BEDRI, Departamenti i komunikimit
Master Shkencor
Titulli i Studimit: “Aspekti propagandistik i filmave gjatë periudhës komuniste”
- Valentin Lleshi, Universiteti i Tiranës, Faktulteti i Historisë
Master shkencor
Titulli i studimit: Persekutimi komunist në rrethin e Kurbinit 1945-1955”

4.2 UDHËHEQJE DIPLOMASH: MASTERI/BACHELOR

2017-2018 - udhëheqje e diplomës për tezën e studimeve "Master" në shkencat e komunikimit të studentes Anjeza Koroni, Kolegji Universitar "Beder" me temën: "Ndikimi i prodhimeve të Kinostudios së Socrealizimit tek të rinjtë në Shqipëri". U shfrytëzuan dokumente, të dhëna dhe arkiva të ISKK. Tezë e mbrojtur më 22 qershor 2018 me rezultatin "shkëlqyeshëm" me 98 pikë.

2017-2018 në ISKK bëri kërkimin shkencor diplomanti Alban Tufa "Propaganda e përcjellë përcjellë përmes poezisë gjatë viteve 1945-1955 në revistën e ish Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Nëntori". Mbrojtja e diplomës u bë me 2 korrik 2018 me rezultatin "shkelqyeshëm", me 100 pikë.

2018 - 2019 vazhdon kërkimin shkencor në arkivat dhe asistencën ISKK për diplomën "master" në shkencat e komunikimit, studentja Ariola Buzi e Kolegjit universitar "Beder", me temë: "Profili vizual i femrës shqiptare në revistat dhe filmat komunizmit".

2017-2018 vazhdoi kërkimin shkencor studenti Florin Zyberaj i Fakultetit të Hstorisë në Fakultetin Filologjik (UT), i cili e finalizoi studimin me botimin e librit shkencor monografik me titull: "Havzi Nela, martiri i fjalës së lirë"

4.3 INTERSHIP

- Sokol Lleshi, Doktor i Shkencave në histori, diplomuar në Universitetin e Europës
Qëndrore, pedagog në
- Universitetin European të Tiranës
- Diola Sokoli, Insituti i Studimeve Europiane
Studente në Master Shkencor

5. AKTE INFORMIMI

5.1 Asistencë informacioni për organet ndërkombëtare të drejtësisë

Gjatë muajve dhjetor 2018 - shkurt 2019 nga ISKK i është përgjigjur kërkesës për informacion të fondacionit shtetëror gjerman "Justitia et Pax" mbi ish komandantit e policisë të kamp-burgut politik të Qafë - Barit (1982-1984) Edmond Caja (tani qytetar gjerman me azil politik), mandej dhe komandant i këtij kamp-burgu (1984-1989). Caja është një prej përgjegjësve kryesorë të dhunës së ushtruar mbi punëtorët e burgosur të këtij kamp-burgu, sidomos me episodin e Revoltës së këtij Burg më 21-23 maj 1984 ku u pushkatuan dy të burgosur, u plagosën e u gjymtuan dhjetra të tjerë, ndërsa, sipas dëshmitarëve okularë, njërit prej tyre, Sandër Sokolli, komandanti Edmond Caja i ka thyer shtyllën kurrizore gjatë torturave.

Siç është bërë e dituar gjerësisht nga mediat shqiptare në Har të RFGJ, ish qytetarja shqiptare (tashmë qytetare gjermane) Ermira Dine, e dalë nga kampet e internimit në vitin 1991, sheh rastësisht mbishkrimin "Edmond Caja" në zyrat e një kompanie biznesi "Travel". Pas identifikimit të personit pronar, ajo bën një ankesë në Bashkinë e qytetit Har, me formulimin: "Ju keni strehuar një kriminel në shtetin tuaj, i cili gjatë diktaturës komuniste ka bërë krime si komandant policie në burgjet komuniste". Pas kësaj ankesë është kundërpërgjigjur Caja, i cili e ka hedhur në gjyq znj. Dine, për "prishje të imazhit publik".

Avokati mbrojtës i znj. Dine, i dërguar nga "Justitia et Pax" Deutsche Kommission, i ka kërkuar informacion ISKK-së.

ISKK ka verifikuar dokumentacionin e plotë të ish komandantit të policisë së burgut, dhe mandej drejtorit të burgut të Qafë-Barit, postet që ka mbajtur deri më 1992, largimin e tij nga Shqipëria dhe kërkimin e Azilit politik në Gjermani si i përndjekur i regjimit komunist. Ne jemi duke e zbardhur plotësisht këtë histori dhe kemi organizuar 64 dëshmitarë okularë për krimet, torturat, gjymtimet dhe vrasjet që ka bërë Edmond Caja me policët e tij në 21-23 maj të vitit 1984 gjatë ditëve të Revoltës së Qafë-Barit. Është marrë kontakti me të gjithë dëshmitarët dhe u është marrë dëshmia si dhe gatishmëria për të dëshmuar para gjyqit.

Janë marrë dokumentat e aktit të lënies së shtetësisë shqiptare nga Caja nga Presidenca (Ministria e Brendshme refuzon t'i japë) dhe i është kërkuar informacion ambasadës së RFGJ mbi dosjen e akteve dhe argumentin e fitimit të azilit politik të tij në Har të Gjermanisë.

Ndërkohë që në adresë të Cajës në Gjermani janë bërë kallëzime penale nga ish të burgosur politikë, dëshmitarë të ngjarjeve makabre të majit 1984.

5.2 Informimi i publikut mbi praninë e ish-pjesëtarëve të Sigurimit të shtetit në institucionet qendrore dhe administratën publike

Në zbatim të detyrave të përcaktuara nga Ligji 10242, datë 25.02.2010, neni 5, shkronja "f", në akord me të cilën ISKK "vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave", Instituti ynë, konform ligjit për të drejtën e informimit, u ka dërguar të gjitha

institucioneve qendrore të administratës së Republikës kërkesën për informacion, nëse ka në organikën e tyre punonjës që kanë qenë pjesë e ish-Sigurimit të shtetit të kohës së diktaturës, të tillë që kanë mbaruar shkollën e lartë të MPB, profili "Sigurim" dhe kanë shërbyer oficerë operativë, hetues, gjykatës, prokurorë, drejtues të lartë të burgjeve dhe kampeve të internimit të shtetit komunist.

E mbështetur në ligjin tonë organik kërkesa e ISKK ka për objekt funksionarët e lartë të rregjimit komunist dhe organet e diktaturës, të cilat përkufizohen në nenin 3 të ligjit, përkatësisht në gërmat "c" dhe "ç" ku sqarohet:

c) "Funksionar i sistemit komunist" është funksionari publik ose personi që gëzonte mbrojtje të barabartë me atë të funksionarit publik, ku përfshihen, në mënyrë të veçantë, funksionarët shtetërorë dhe funksionarët e lartë partiakë.

ç) "Organet e diktaturës komuniste" janë organet që kanë vepruar gjatë periudhës së komunizmit dhe, konkretisht, ish-Sigurimi i Shtetit, organet e inteligjencës në ushtri, Ministria e Brendshme, Policia Popullore, forcat kufitare, repartet e ndjekjes në Ministrinë e Brendshme, si dhe personeli i burgjeve e i kampeve të internimit.

Në organe të diktaturës komuniste vlerësohen edhe pjesëmarrja dhe veprimtaria e njëjësive, strukturave dhe individëve të hetuesisë, prokurorisë e gjykatave, në shërbim të veprimtarisë së strukturave të përmendura në këtë paragraf.

Shkak për kërkesën tonë institucionale ka qenë gjithashtu dhe shqetësimi i ngritur herë pas here nga ish të burgosurit politikë, mediat dhe informacioni i dosjeve të ndryshme dhe materialet arkivore me të cilët punojmë. Të gjitha këto informacione tregojnë për një tejngopje viteve të fundit me punonjës, që kanë qenë para vitit 1991 pjesë e armës së ish-Sigurimit të shtetit, të drejtësisë komuniste të diktaturës. Për ligjin dhe sensibilitetin e çështjeve që trajtojmë ne në studimet tona kjo, sigurisht është e rëndë dhe e papranueshme.

Mjafton të pohojmë, me fjalë të kursyera, çfarë ishte ish-Sigurimi i Shtetit:

Sigurimi i Shtetit, i MPB-së, ishte armë e specializuar e Partisë së Punës për zhvillimin e mprehtë të luftës së klasave. Ndiqte kategoritë e përcaktuara si "armike" të pushtet për shkak të origjinës së tyre, figurat e përcaktuara si krime kundër shtetit: agjitacioni e propaganda, tradhtia ndaj atdheut, formimi i organizatave kundër pushtetit, etj.

Sigurimi përcaktonte personat që internoheshin dhe do dënoheshin me burgim apo me vdekje. Po ashtu përcaktonte personat që do ekzekutoheshin në kushte lufte. Duke qenë se kjo veprimtari ushtrohej kundër grupeve të spikatur të shoqërisë, si dhe ndaj trashëgimtarëve të tyre, veprimtaria e Sigurimit është gjenocid mbi njerëzimin dhe përputhet me parimet që ka vlerësuar OKB-ja (për gjenocidin)

Kërkesat tona u janë drejtuar institucioneve qendrore të shtetit, ministrive, institucioneve të pavarura shtetërore në varësi nga Parlamenti dhe Kryeministri. Pak a shumë kërkesa për informacion ka këtë formulim:

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve të rrjedhura nga ligji nr.10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri ” (neni 3/ç, 5/ë), ndër të cilat është edhe identifikimi i personave që kanë qenë pjesë e makinës së diktaturës komuniste, kërkojmë nga ana juaj listën e personave ish-oficerë, të cilët kanë mbaruar Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, profili “Sigurim” dhe që mund të gjenden të punësuar në institucionin që drejtoni ju...

Përgjigjet e kthyer nga shumica dërrmuese e titullarëve të institucioneve shprehen se nuk kanë në strukturat e tyre punonjës të tillë, ndërsa një pjesë e institucioneve qendrore, që sipas të dhënave tona janë edhe më problematike, refuzojnë të japin informacion, ndër të cilët dukshëm e demonstrativisht refuzojnë dhënien e informacionit, pa ndonjë argument ligjor, janë drejtori i SHISH, z. Helidon Bendo; Ministria e Brendshme, z. Sandër Lleshaj; Akademia e Sigurisë, z. Bilbil Mema; Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kolonel Bardhyl Nuredinaj etj.

Edhe në rastet kur në përgjigjet e tyre konfirmojnë se "nuk ka asnjë punonjës që të ketë qenë pjesë e ish Sigurimit të shtetit", ne e kuptojmë sipas të dhënave tona, që kjo përgjigje është e gënjeshtërt, pasi informacioni ynë është i kundërt me përgjigjet e tyre. Në këto kushte ne na duhet të konsumojmë procedurën ligjore të parashikuar për mosdhënien e informacionit, duke e llogaritur këtë mos dashje si pengesë në kryerjen e detyrës që na keni ngarkuar me ligj, pa llogaritur këtu mashtrimin e opinionit qytetar.

Në mënyrë absurde disa institucione shumë të rëndësishme quajnë "sekret shtetëror" diplomat e arsimimit, pra si të klasifikuara "sekret shtetëror" apo “të dhëna sensitive”. Nga ana tjetër, ka një pjesë të institucioneve të cilët kanë dhënë me saktësi e krejt korrekt informacionin e saktë, sipas kërkesës sonë.

Problemi mbetet mosdhënia, apo më mirë, mosdashje për të dhënë informacionin e kërkuar. ISKK do të vijojë të raportojë hollësisht Komisionin e Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, deri në shterrimin e plotë të përgjigjeve që vijnë, pas rikujtimit dhe replikave për interpretimin e referencave në Ligj.

6. PARTNERITETE

6.1 PARTNERË VENDAS

- Instituti i Integritimit të të Përndjekurve Politikë
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencave të Shqipërisë
- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentimin e Ish-Sigurimit të Shtetit

- Muzeu historik “Shtëpia e gjetheve”
- Instituti për Demokraci, Media dhe Komunikim
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i Historisë
- Instituti i Shkencave Politike
- Minisria e Kulturës së Shqipërisë
- Qendra Musine Kokalari
- Biblioteka Kombëtare
- Instituti i Traumës dhe Rehabilitimit
- Akademia e Multimedias MARUBI
- Forumi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut
- Shoqatat e Ish të Përndjekurve politikë

6.2 PARTNERË NDËRKOMBËTARË

- Fondacioni “Konrad Adenauer”, në Tiranë (partner kryesor)
- Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur (Gjermani)
- Albanian Human Rights Project (AHRP), SHBA.
- European Solidarity Centre, (“Permanent Exhibition Section”, Gdansk, Poloni.)
- Federal Foundation for the Reappraisal of the SED Dictatorship, Berlin.
- “European Remembrance” netëork, Berlin.
- The Platform of European Memory and Conscience (*Me 16 nëntor 2018, Institui i Studimit të Krimeve të Komunizmit (ISKK) pranohet anta i Platformës Europiane të Kujtesës (The Platform of European Memory and Conscience).*

III. MENAXHIMI BUXHETOR

a. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Për vitin 2018 Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është strukturuar në dy drejtori dhe në një sektor përkatësisht: - Drejtoria e Studimeve Shkencore, Drejtoria e Arkivës dhe Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Struktura, marrëdhëniet dhe detyrat e këtyre drejtorive, rregullohen përveç legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit, e cila ka përcaktuar në mënyrë të detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat për kryerjen e veprimtarisë së secilës prej këtyre drejtorive dhe sektorit.

Emërimi i personelit të institucionit, është bërë në zbatim të ligjit nr.10242 datë 25.02.2010 “Për krijimin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” neni 13 i tij si dhe në bazë të VKM-se nr.191, datë 23.02.2011 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”.

Në Organikën dhe Strukturën institucionit tonë janë 15 punonjës.

Gjatë vitit 2018 janë evidentuar zhvillimet e mëposhtme deri në plotësimin e të gjitha vendeve sipas strukturës:

Bazuar në pozicionet vakante të miratuara për shkak të largimeve, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të legjislacionit të shërbimit civil apo Kodit të Punës, u krye procesi i rekrutimit dhe emërimit për pozicionet:

- 1
(një) punonjës administrativ (sekretare/protokoll në Sektorin e Financës/Buxhetit dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Për sa më sipër dhe në zbatim të ligjit nr.103, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, numri i punonjësve të ISKK për vitin 2018, ka qenë 15 punonjës.

ORGANIKA E STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË STUDIMEVE PER KRIMET E PASOJAT E KOMUNIZMIT NE SHQIPERI

<i>POZICIONI</i>	<i>NUMRI</i>
I. DREJTORI EKZEKUTIV	1
SEKRETAR/ARKIVIST	1
II. DREJTORIA E ARKIVES/NENDREJTORI	(4)
DREJTOR DREJTORIE/NENDREJTOR	1
SPECIALIST	3
III. DREJTORIA E STUDIMEVE	(5)
DREJTOR DREJTORIE	1
SPECIALIST	4
IV. SEKTORI I BUXHETIT, FINANCËS	
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(4)
PERGJEGJES SEKTORI	1
SPECIALIST	2
SHOFER	1
PUNONJËS GJITHSEJ	15

Gjithashtu gjatë vitit 2018, ISKK në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor dhe Deklarimin e Interesave Para Fillimit të Detyrës, sipas legjislacionit në fuqi.

b. MENAXHIMI FINANCIAR ISKK PËR VITIN 2018

Mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 103, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si edhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2018, dhe situata buxhetore me

treguesit e realizimit të buxhetit të Institutit të Studime të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, për periudhën Janar - Dhjetor 2018, paraqitet si në tabelën më poshtë:

Nr	Emërtimi	Plan vjetor 2018	Plani i rishikuar 2018	Fakt 12 mujori	Në %
1	Shpenzime për Paga	18,330,000	18,330,000	15,282,087	83.4%
2	Sigurime shoqërore	2,970,000	2,970,000	2,329,706	78.5%
3	Mallra e Shërbime	11,400,000	10,000,000	9,173,109	91.7%
4	Shpenzime për Investime	1,000,000	1,000,000	782,960	78.3%
	Totali i Shpenzimeve	33,700,000	32,300,000	27,567,862	85.5%

Në Shpenzimet e përgjithshme, duke u bazuar në buxhetin e vitit 2018 në fund të këtij viti, kanë arritur në 27,567,862 lekë, nga 32,300,000 lekë që është buxheti i rishikuar për vitin 2018, duke u realizuar në masën 85.5% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 4,732,138 lekë. Shpenzimet korente në fund të vitit 2018, kanë arritur në shumën rreth 9,173,109 lekë ose rreth 91.7% e buxhetit të rishikuar, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 826,891 lekë.

Gjithashtu, në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve:

Artikulli	Emërtimi	Realizimi vjetor 2018	Stuktura në %
600	Shpenzime për Paga	15,282,087	55.32
601	Sigurime shoqërore	2,329,706	8.45
602	Mallra e Shërbime	9,173,109	33.3
231	Shpenzime për Investime	782,960	2.93
	Totali i Shpenzimeve	27,567,862	100

Shpenzimet në fondet e buxhetit në zërin “paga dhe sigurime shoqërore” rezultojnë me mospërdorim të fondit prej 3,688,207 lekë. si pasojë e mos plotësimit që nga fillimi i vitit të vendeve vakante të numrit të punonjësve të planifikuar.

Sa i takon zërit “shpenzime për mallra e shërbime”, gjatë vitit 2018, rezulton me një realizim vjetor prej 9,173,109 lekë nga 10,000,000 lekë i planifikuar, pra i realizuar 91.7%, duke shlyer edhe pjesën më të madhe të detyrimeve.

Ndërkohë, shpenzimet kapitale deri në fund të vitit 2018, janë realizuar në masën 782,960 lekë pra në masën 78.3%, duke realizuar disa nga kërkesat për pajisje zyre dhe pajisje kompjuterike të punonjësve për vitin 2018.

Nga sa më sipër rezulton se, në përgjithësi të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar në masën e planifikuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2018-2020.

Shpenzimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për ISKK janë realizuar me efikasitet, duke bërë që puna të vijojë me efektshmëri dhe duke plotësuar nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.

Përgjegjës Sektori

Zoica GRAÇI

Tiranë më 22.01.2019

IV. PROBLEMATIKA DHE VIZIONI PËR VITIN 2019

a. Problematika

Gjatë vitit 2018, u ricikluan të njejtat pengesa me të cilat u ndeshëm edhe gjatë vitit 2017 në lidhje me ndarjen e punës, përmbylljen në kohë të projekteve, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të punonjësve, krahasuar me volumin e punës që i përket këtij insitucioni në përputhje me detyrat që i ngarkon ligji, dhe në varësi të urgjencës që paraqesin disa prej projekteve. Në vitin 2016, me kërkesën tonë, ISKK-së i akorduan fondin për katër pozicione të reja pune, të cilët çuan në konceptimin e një organigrami të re. Kjo strukturë u argumentua dhe u mbështet nga Ministria e Financave dhe DAP-i, por përfundimisht mbeti një nismë e lënë pezull, e pafinalizuar edhe gjatë vitit 2018, për shkaqe burokratike që nuk varen nga ne. Ndërkohë aktiviteti i dy drejtorive, Drejtorisë së Studimeve dhe Drejtorisë së Arkivës, sa vjen dhe bëhet më ambicioz dhe më i gjërë, duke shtruar me forcë jo vetëm nevojën e zgjerimit të stafeve, por edhe të profileve profesionale. Fjala vjen, përfshirja e filmit dhe projekteve online, shtrojnë nevojën e të paktën një eksperti të profilit multi-media; prurjet e mëdha të memuareve, shtrojnë nevojën e një redaktori; nevojat kërkimore shtrojnë nevojën e specialistëve të tjerë të kësaj fushe.

E njejta gjë mund të thuhet edhe për hapësirën tejet të kufizuar të ambjenteve të ISKK, që është gjithashtu një problem i trashëguar. Pëveç zyrave që janë jokomode për kushtet e punës së një studjuesi, mungon salla për magazinimin e librave, salla për trajnime apo workshope, salla e leximit apo salla e bibliotekës. Aktualisht, në Institut mungon edhe hapësira për arkivimin e dokumentacionit. I njejti problem qëndron edhe për arkivimin e objekteve të mbledhura ndër vite për muze.

Sadoqë mungesa e hapësirës nuk ka ndikuar në mbarëvajtjen e veprimtarisë së ISKK deri tani, gjithsesi duhet marrë parasysh kufizimi që na dikton kjo situatë në aspektin logjistik, por edhe atë financiar, sepse për aktivitete të cilat fare mirë mund të zhvilloheshin në ambjentet e Institutit, ne na duhet të marrim salla me qera. Shtoji kësaj edhe faktin që ISKK, për shkak të emrit dhe pozicionit që ka, frekuentohet rregullisht nga turistët, sidomos të huajt, dhe ne nuk jemi në gjendje të krijojmë qofte edhe një dhomë të vogël muze apo një lloj ekspozije të përkohshme me materialet, objektet, botimet dhe çdo gjë produkt tjetër material me të cilën lidhet simbolika e këtij institucioni.

b. Vizioni për vitin 2019

Në vazhdimësi të një plani strategjik, një nga prioritetet e ISKK gjatë vitit 2019, do të jetë trashëgimia materiale komuniste. Ky master-plan, do të shtrihet në tre drejtime: produkt, kualifikim, fushatë sensibilizuese. Parashikohen një mori aktivitete të tilla si: krijimi i muzeut virtual të Burgut të Ballshit, konferenca mbi trashëgiminë materiale që mbahet me 25 shkurt 2019, ekspozita online, trajnime të grupeve vullnetare mbi gjetjen e artefakteve që simbolizojnë këtë periudhë, krijimi i një network-u me institucione të tjera të kujtesës posaçërisht mbi këtë temë, realizimi i një fushate ndërgjegjësimit duke përdorur mediat sociale, dhe trajnimi i dy specialistëve. Vënia e trashëgimisë materiale si fjalë çelës për vitin 2019, vjen si rezultat i përvojës disavjeçare të ISKK mbi këtë temë, por edhe i projekteve specifike përgatitore.

Database-i dhe arkiva audio-vizuale e dëshmimeve të mbijetuarve, vazhdojnë të mbeten një aktivitete konstante dhe intensive, ndërkohë që do të forcohet aksesimi i tyre publik përmes publikimit online, prodhimit të filmave, apo shpërndarjes me të drejtë përdorimi të këtij informacioni në site të tjera të kujtesës, siç ka qenë vitin që shkoi faqja KUJTO. AL.

Ndërkohë projekti arsimor vazhdon të mbetet mjaft i rëndësishëm dhe ISKK tashmë ka përgatitur kalendarin e përfërt të takimeve nëpër shkolla. Por, përveç alternimit të bisedës nëpër shkolla me vizitat në muze (që qe një risi vitin që shkoi), gjatë vitit 2019, synojmë që të pasurojmë programin edukues me forma interaktive, si: shfaqjen e muzet virtual, përfshirjen e historive të personalizuara të projektit MEMO, rikrijimin e historisë së komunizmit përmes metodave të pedagogjisë moderne, etj.

Përveç botimeve të përvitshme, në vitin 2019, ISKK parashikon gjithashtu një seri konferencash, kombëtare dhe ndërkombëtare, por me tematika më të specifikuar se më parë, si: Lufta e Dytë Botërore dhe ardhja e komunistëve në pushtet; baza ligjore e internim-dëbimeve. Po kështu

ISKK parashikon të bashkëpunojë me institucione të tjera të kujtesës, në të tjera konferenca mbi çështje të cilat janë objekt studimor i saj.

Gjatë 2019, parashikohet edhe kualifikimi i mëtejshëm i punonjësve përmes kurseve të trajnimit apo workshop-eve brenda dhe jashtë vendit, veçanërisht lidhur me menaxhimin e dëshmive orale, dixhitalizimin e dokumentacionit, përpunimin e artefakteve, etj.

FALEMNDERIT!

Përgatitën raportin:

Drejtori Ekzekutiv i ISKK

Agron TUFA

Drejtorja e Studimeve

Luljeta LLESHANAKU

Drejtorja e Arkivës

Çelo HOXHA

Tiranë, 24 shkurt 2019